

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Fakulteti i Drejtësisë
Правен факултет
Faculty of Law

E DREJTA CIVILE

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA:

**“PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
GJATË PERIUDHËS 2012-2016”**

Kandidat:

Aurela Beka

Mentor:

Doc.dr. Arta Selmani - Bakiu

Tetovë, 2022

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Fakulteti i Drejtësisë
Правен факултет
Faculty of Law

E DREJTA CIVILE

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA:

**“PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
GJATË PERIUDHËS 2012-2016”**

Kandidat:

Aurela Beka

Mentor:

Doc.dr. Arta Selmani - Bakiu

Tetovë, 2022

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Aurela Beka, studente në Fakultetin Juridik në Universitetin e Europës Juglindore-Tetovë, deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e këtij punimi.

Aurela Beka

Lektoroi:

Dr. Shukrie Rama

ABSTRAKT

Martesa si institucion juridik me rëndësi të madhe në shoqërinë kosovare kryen funksione të rëndësishme shoqërore, e cila gëzon mbrojtje shoqërore dhe shtetërore. Një ndër funksionet më të rëndësishme për shoqërinë është krijimi i familjes. Për lidhjen e martesës së vlefshme duhet të ekzistojnë kushtet ligjore të cilat janë të parapara me Ligjin për Familjen.

Mirëpo, në ligj parashihen edhe dispozita për mënyrat e zgjidhjes së martesës së vlefshme mes bashkëshortëve. Një nga mënyrat e shuarjes së martesës së vlefshme është shkurorëzimi. Kompetente për zgjidhjen e kësaj mënyre të martesës është vetëm Gjykata Themelore e cila me aktgjykim përfundimisht realizon zgjidhjen e martesës së vlefshme.

Me zgjidhje të martesës paraqiten edhe pasoja juridike të natyrave të ndryshme, të cilat mund të jenë të karakterit juridik jo pasurore (pasoja juridike për bashkëshortët dhe pasojat juridike për fëmijët) dhe pasoja juridike të natyrës pasurore mbarimin e regjimit pasuror.

Fjalët kyçe: Martesa, familja, shkurorëzimi, pasojat juridike, ligji.

ABSTRACT

Marriage as a legal institution of great importance in our society performs important social functions which contains social and state protection. One of the most important functions for society is the creation of the family. There must be legal conditions for entering into a valid marriage which are provided in the Family Law.

However, as the conditions for entering into marriage, the law also provides legal provisions for the days of dissolving a valid marriage of spouses. One of the ways to terminate a valid marriage is divorce, competent for the dissolution of this way is only the basic court which with a judgment realizes the dissolution of the valid marriage.

Divorce of marriage also presents legal consequences of different nature, which can be: non-property legal consequences and legal consequences of property nature.

The non-property legal consequences are divided into two groups: the legal consequences for the spouses and the legal consequences for the children. Legal consequences of a property nature include the termination of the property regime.

Keyëords: Marriage, Family, Divorce, Legal consequences.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORIT	4
ABSTRAKT	5
ABSTRACT	6
PËRMBAJTJA	7
1. Qëllimi i punimit	9
2. Metodologjia e hulumtimit	9
3. Lënda e hulumtimit	11
4. Hipoteza	11
HYRJE	13
KAPITULLI I	14
1. ZHVILLIMI HISTORIK I INSTITUTIT TË MARTESËS	14
1.1. Rregullimi juridik i martesës në të Drejtën Romake	14
1.2. Instituti historik i martesës ndër shekuj	15
1.3. Instituti historik i martesës në Kosovë	16
KAPITULLI I DYTË	17
2. ZGJIDHJA E MARTESËS DHE PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT	17
2.1. E drejta martesore, objekti dhe subjekti	17
2.2. Parimet Themelore të së Drejtës Martesore	18
2.3. Kuptimi, llojet e të drejtave dhe detyrimet e bashkëshortëve	20
2.4. Zgjidhja e martesës	22
2.4.1. Shkurorëzimi si mënyrë e zgjidhjes së martesës	26
2.5. Shkaqet e shkurorëzimit	29
2.6. Procedurat e shkurorëzimit	31
2.7. Pasojat juridike të shkurorëzimit	32
2.8. Praktika juridike	33
KAPITULLI 3	38
3. PASOJAT JURIDIKE PASURORE TË SHKURORËZIMIT	38

3.1. Pasojat juridike të zgjidhjes martesore	38
3.2. Llojet e pasurisë së bashkëshortëve	39
3.2.1. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve	39
3.2.2. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve	40
3.2.3. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët pasurore	42
3.2.4. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore me marrëveshje	43
3.2.5. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nga ana e gjykatës	44
3.2.6. Vlerësimi i pasurisë së përbashkët dhe llogaritja e kontributit	45
3.3. Kthimi i dhuratave në mes bashkëshortëve të shkurorëzuar	47
3.4. E drejta e banimit mes bashkëshortëve të shkurorëzuar	48
3.5. E drejta e trashëgimisë mes bashkëshortëve të shkurorëzuar	49
3.6. Detyrimi i ushqyerjes së fëmijëve mes bashkëshortëve të shkurorëzuar	50
KAPITULLI I KATËRT	52
4. PASOJAT JURIDIKE PERSONALE TË SHKURORËZIMIT	52
4.1. Pasojat juridike të karakterit personal mes bashkëshortëve	52
4.2. E drejta e lidhjes së serishme të martesës	53
4.3. Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët e përbashkët	53
4.4. Kujdestaria e fëmijëve me rastin e shkurorëzimit	54
4.4.1. Roli i organit të kujdestarisë në procedurën e dhënies së kujdestarisë për fëmijë	54
4.4.2. Kontaktet personale të prindërve të shkurorëzuar me fëmijët e tyre	55
4.4.3. Kujdestaria e përbashkët pas shkurorëzimit - Joint Custody	56
4.5. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit	58
4.6. Praktika gjyqësore lidhur me shkurorëzimet dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët të fituar gjatë bashkësisë martesore, dhe ANKETA	59
PËRFUNDIME	69
REKOMANDIME	73
BIBLIOGRAFIA	75

1. Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë në aspektin krahasimor institutin e së drejtës familjare “Martesën” dhe pasojat që rrjedhin nga shkurorëzimi në Kosovë gjatë periudhës 2012-2016.

Çështje e rëndësishme në këtë punim është analizimi dhe studimi i hollësishëm jo vetëm i kuadrit normativ, por edhe i qëndrimeve të teorisë juridike dhe praktikës gjyqësore, veçanërisht në aspektin që i referohet të drejtës për të zgjidhur martesën, mënyrave të zgjidhjes së saj, procedurës që duhet ndjekur si dhe pasojave personale dhe pasurore që rrjedhin nga shkurorëzimi.

Gjatë punimit të kësaj teme do ofrohen burime të mjaftueshme praktike të punës së gjykatave nga kjo problematikë - e shkurorëzimit, duke u bazuar në burimet ligjore.

Studimi i kësaj teme e ka vlerën e saj edhe më të madhe duke pasur parasysh faktin se numri i shkurorëzimeve është mjaft evident dhe pasojat janë të mëdha në raport me familjen e sidomos në raport me fëmijët. Qëllimi i këtij punimi është që të bëhet një analizë krahasuese e ligjeve në Kosovë dhe atyre në rajon e më gjerë, me qëllim që nga ky punim të dalin rekomandime të cilat do reflektojnë në mënyrë efikase në punën e institucioneve kompetente dhe të ngritjes së vetëdijes individuale dhe kolektive për pasojat që dalin nga një raport i tillë i shkurorëzimit.

2. Metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij punimi, gjatë hulumtimit, u aplikuan metoda bashkëkohore që zbatohen në shkencat shoqërore. Metodologjia e cila u aplikua gjatë hulumtimit të punimit përmban metoda teknike relevante kërkimore hulumtuese. Në hulumtim u përdorë literaturë përkatëse bashkëkohore studimore si: libra universitarë, revista shkencore, punime profesionale – shkencore, vendime gjyqësore lidhur me çështjet familjare etj. Po ashtu u shfrytëzuan edhe burimet e hapura siç janë ueb faqet e ndryshme dhe analizat e raporteve vjetore të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare në Kosovë. Vetë natyra e cila është objekt studimi kërkon që të zbatohen edhe metoda të caktuara shkencore.

Metodat e përdorura në këtë punim janë:

Metoda historike - gjatë hulumtimit shkencor të një fenomeni rëndësi të posaçme duhet t'i kushtohet metodës historike nëpërmjet së cilës d shqyrtohet ekzistenca dhe evoluimi i martesës në aspektin historik, forma dhe mënyrat e paraqitjes në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, duke përfshirë edhe atë nga aspekti i të drejtës zakonore shqiptare, etj.

Metoda e analizës juridike - me anë të kësaj metode do të arrihet të evidentohet aspekti juridik i institutit të së drejtës familjare "Martesës" dhe pasojat juridike të shkurorëzimit. Përmes kësaj metode paraqiten: definicioni i martesës, karakteristikat, pasojat juridike të shkurorëzimit, etj.

Metoda komparative - kjo metodë aplikohet për të hulumtuar në aspektin e krahasimit të legjislacionit që rregullon çështjen martesës dhe shkurorëzimit në Kosovë dhe të disa vendeve të tjera të rajonit dhe më gjerë.

Metoda statistikore – me anë të kësaj metode grumbullohen të dhënat statistikore të evidentuara si të dhëna zyrtare për shkurorëzimet dhe pasojat juridike të saj, etj. Këto dhëna do të grumbullohen dhe hulumtohen në gjykatë, në zyrat e avokatisë, Agjencinë Statistike të Kosovës, etj.

Përmes metodave të lartcekura do të njihet, trajtohet dhe analizohet në baza shkencore dukuria e martesës si institut juridik i të Drejtës Familjare dhe pasojat juridike të shkurorëzimit.

3. Lënda e hulumtimit

Problem i hulumtimit Punimi është i orjentuar kryesisht në analizën e institutit të martesës, pasojat juridike që rrjedhin nga zgjidhja e saj në Republikën e Kosovës gjatë periudhës kohore 2012 – 2016, duke mos përjashtuar edhe atë në disa vende të regjionit.

Çështje të kërkimit shkencor janë të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve për të mbajtur dhe avancuar një raport të tillë martesor, por edhe pasojat juridike dhe faktike që shfaqen në rast të shkurorëzimit mes bashkëshortëve, duke përfshirë edhe pretendimet e tyre për një ndarje të barabartë të pasurisë së krijuar gjatë martesës dhe fitimit të drejtës së mbikëqyrjes prindërore në raport me fëmijët e tyre.

Problematika e lartcekur është shumë aktuale në Kosovë, e sidomos pas periudhës së luftës në Kosovë, për këtë edhe kjo temë ka një rëndësi të veçantë si temë studimi në rastin konkret. Një konstatim i tillë bazohet në disa fakte relevante: Dinamika e zhvilluar e jetës; Barazia gjinore mes gruas dhe burrit në shoqëri, e në veçanti në familje; Avancimi i të drejtave dhe obligimeve të bashkëshortëve në familje dhe jashtë saj; Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijëve të lindur në martesë, etj. janë disa nga faktorët që kanë ndikuar që kësaj problematike t'i kushtohet një rëndësi e veçantë e studimit. Problematikat e tilla do të hulumtohen edhe në disa vende tjera të regjionit ku do të aplikohet metoda komparative në raport me çështjet e njëjta në Republikën e Kosovës.

4. Hipoteza

Punimi trajton nocionin dhe pasojat juridike mbi të cilat funksionon instituti i martesës respektivisht, çështja e zgjidhjes së saj dhe pasojat juridike të shkurorëzimit mes bashkëshortëve. Hipotezat e zhvilluara në këtë punim janë:

1. Si është e rregulluar e drejta martesore në Republikën e Kosovës, në shtetet e rajonit dhe në disa shtete evropiane?

2. Cilat janë dallimet esenciale të martesës dhe shkurorëzimit në legjislacionet e ndryshme në rajonit dhe më gjerë?
3. Cilat janë pasojat juridike të shkurorëzimit mes bashkëshortëve dhe efektet e tyre ndaj fëmijëve, etj.?

- **Pyetjet kërkimore bazë për këtë punim janë:**

Ky punim synon të japë përgjigje sa më të plota dhe të sakta në mënyrë profesionale, ligjore dhe praktike për çështjet e mëposhtme:

- a) Çfarë është e drejta e martesës dhe e shkurorëzimit?
- b) Cilat janë karakteristikat e tyre?
- c) Cilat janë parimet e të drejtës martesore?
- d) Cilat janë mënyrat e zgjidhjes së martesës?
- e) Cilat janë kushtet ligjore dhe procedurale për lidhjen e martesës?
- f) Cilat janë pasojat juridike – ligjore të martesës dhe shkurorëzimit, etj.?

HYRJE

Sipas dispozitave ligjore martesë definohet bashkësi mes dy personave të gjinive të ndryshme e rregulluar me ligj, e lidhur në bazë të vullnetit të lirë me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes (Neni 14, LFK). Martesa është bazë e familjes, prandaj për këtë gëzon mbrojtje shoqërore dhe shtetërore. Në Ligjin për Familje të Kosovës janë përcaktuar kushtet për ekzistimin e martesës. Në ligj janë paraparë edhe pengesat martesore që pengojë lidhjen e martesës së vlefshme të cilat kanë pasojë edhe nulitetin e saj (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 18 LFK).

Shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e martesës së plotfuqishme gjatë jetës së përbashkët të bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, sipas kushteve të caktuara me ligj. Martesa cilësohet e zgjidhur nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të sjellë/nxjerrë nga Gjykata Themelore. Me lidhjen e martesës krijohen edhe të drejta dhe detyrime në mes të bashkëshortëve. Me zgjidhjen e martesës paraqiten pasoja juridike të cilat kanë karakterin pasuror dhe jo pasuror, ku përfshihen edhe subjektet si bashkëshortët, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të përbashkët (Podvorica, 2006, fq.135).

Pasojat juridike personale për zgjidhjen e martesës të bashkëshortëve janë: mbiemri, ndarja e pronës pasurore, kthimi i dhuratave, detyrimi i ushqimit, e drejta e banesës/banimit, trashëgimia ligjore dhe testamentare, ndërsa pasojat juridike të zgjidhjes së martesës në mes të bashkëshortëve dhe fëmijëve janë: besimi, ruajtja dhe mbajtja e fëmijës (Podvorica, 2006, fq.136).

Ligji për Familjen e Kosovës në pjesën lidhur me shuarjen e familjes rregullon edhe marrëdhëniet në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe personave të tretë (Neni 71-80 LFK).

KAPITULLI I

1. ZHVILLIMI HISTORIK I INSTITUTIT TË MARTESËS

Në këtë kapitull shpjegohet analiza e konceptit të institutit të martesës gjatë shekujve. Në pjesën e parë prezantohet rregullimi juridik i martesës në të drejtën romake, pasi që shumë ligje të shteteve të ndryshme janë të bazuara në të drejtën romake (Bilalli & Bahtiri, 2015, fq.170). Në pjesën tjetër punimi fokusohet në institutin historik të martesës ndër shekuj, ndryshimet e konceptit për martesën, ku në fund shpjegohen në mënyrën analistike dhe krahasimore koncepti i martesës dhe zhvillimi i saj si institut historik në Kosovë.

1.1. Rregullimi juridik i martesës në të Drejtën Romake

“Martesa është njëri nga institutet më të vjetëri të njerëzimit dhe familjes, e cila ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit, por çdo herë ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve seksuale ndërmjet bashkëshortëve, dhe sigurimin e pasardhësve” (Bilalli & Bahtiri, 2015, fq.170). Në të drejtën romake martesa ishte bashkësi e përhershme jetësore midis burrit dhe gruas, ku të drejtat dhe detyrimet kanë qenë të vendosura nga pushteti i burrit (Mandro, 2004, fq.125). Ndërsa sipas autorëve të tjerë, pushtetin mbi gruan e ushtronte vetëm burri, sepse me lidhjen e martesës - manus, “patria potestas” ajo e humbiste pushtetin mbi vajzën e saj dhe ajo i ndërpriste të gjitha lidhjet me domusin e mëparshëm, ku e tërë pasuria e gruas në martesën “cum manu” kalonte mbi kryetarin e familjes së re (Podvorica, 2006, fq.61). Romakët e definonin martesën në këtë kuptim shoqëror: “ Martesa është bashkimi i gruas dhe i burrit, një lidhje e përhershme dhe komunikim i të drejtës hyjnore dhe njerëzore” (Mandro, 2004, fq.124; Olldashi, 2011, fq. 52). Ky bashkim në mes të gruas dhe burrit ishin bashkësi egzogame, ku meshkujve dhe femrave iu lejohej martesa vetëm që ishin të lindur jashtë bashkësisë familjare që u takonin, me kusht që subjektet të cilat lidhnin martesë kishin arritur moshën e pubertetit, pra të kishin zotësinë e veprimit. Që të krijojë (prodhojë) efekte juridike martesa e plotfuqishme romake duhej të lidhet në njërën nga format e parapara me ligj, “conferratio”, “coemptio”, ose “usus”. (Bilalli & Bahtiri, 2015, fq. 173). Që martesa të jetë e

plotfuqishme, përveç kushteve të rëndësishme, duhet që gjatë lidhjes bashkëshortore të mos ekzistojnë pengesa martesore të cilat të shpijnë drejtë rrugës së anulimit të martesës apo krijimi i martesës së jo plotfuqishme. Pengesat martesore ndahen dy kategori: pengesa absolute, e cila konsiderohej martesë ekzistuese dhe ajo relative e cila ishte gjinia e gjakut, pasi që martesë ishte e ndaluar ndërmjet subjekteve që kishin lidhje të gjakut (Bilalli & Bahtiri, 2015, fq.173).

1.2. Instituti historik i martesës ndër shekuj

Martesa gjatë periudhës së feudalizmit rregullohej me të drejtën kanonike, si pasojë e ndikimit të kishës, është konsideruar më shumë institut hyjnor sesa institut juridik, pasi që e drejta kishtare nuk lejonte zgjidhjen e martesës, mirëpo lejonte vetëm ndarjen e bashkëshortëve nga shtrati dhe tryeza (Ismaili, Sejdiu, 2009, fq. 168).

E drejta kishtare caktonte kushtet dhe parashihte pengesat për lidhjen e martesës. Pengesat relative dhe absolute kanë qenë: ekzistimi i martesës së mëparshme të vlefshme, përkatësia e shtresës së lartë klerikale dhe murgjve (më vonë u shtri në të gjithë klerikët) dhe mungesa e pagëzimit. Ndërsa në pengesat relative parashihte afërsinë e gjakut dhe të gjitha afërsitë e tjera. Të afërmit e gjakut deri në shkallën e shtatë nuk mund të lidhnin martesë (Ismaili, Sejdiu, 2009, fq. 168).

Ideja dhe koncepti i martesës në fillim të shekullit shtatëmbëdhjetë (XVII) ndryshoi. Martesa filloi të bazohet në dashuri dhe jo vetëm në shkas për të krijuar familje apo ruajtjen e fisit. Ky koncept pati përhapje shumë të madhe, ku njerëzit arritën të kuptonin një pikëpamje tjetër për martesën, lumturinë dhe dashurinë. Disa nga shtetet njohën dhe rregulluan me norma ligjore edhe zgjidhjen e martesës (Podvorica, 2006, fq. 117).

1.3. Instituti historik i martesës në Kosovë

Instituti i martesës në Kosovë ka pësuar shumë ndryshime. Një rol të rëndësishëm kanë pasur traditat dhe zakonet, të cilat kanë qenë të përmbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit instituti i martesës kishte kuptim:

“M’u martue më kanun do’me thanë m’u ba shpi, me ia shtue shpis një rob ma tepër, sa për krah të punve, sa për të shtuem të fmive.” (Kanuni i Lekë Dukagjini, neni 28). Pra, koncepti i martesës ka qenë vetëm krijimi i shtëpisë, gruaja është cilësuar si rob edhe fëmijët janë konsideruar punëtor të punës. Këto koncepte arritën të ndryshojnë pas Luftës së Dytë Botërore, kur çështja e familjes dhe martesës rregullohen me Ligjin Themelor për Martesë, më datë 13 prill 1946, i cili gjeti zbatim në tërë territorin e ish-RSFJ-së. Ky ligj bazohet në parimin e laicitetit, parimin e martesës civile, parimin e barazisë në mes gruas dhe burrit, institucioni i pasurisë së përbashkët etj (LTHM, 1946). Më datën 01.09.2006, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji për Familjen i Kosovës me nr. 2004/32. Ky ligj shënon një përparim të mëtejshëm të marrëdhënieve familjare dhe martesore, duke e renditur Kosovën në grupin e vendeve me rregullativë juridike familjare të kodifikuar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare (Podvorica, 2005, fq. 24). Ky ligj është i përbërë nga tetë (8) pjesë. Pjesa e parë përmban dispozitat të përgjithshme lidhur me marrëdhëniet familjare; parimet dhe institutet themelore të cilat dalin nga marrëdhëniet familjare (neni 1-24). Pjesa e dytë, rregullon fejesën dhe martesën si institute të veçanta juridike lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto dy institute (neni 9-13). Pjesa e tretë, parasheh dispozitat të cilat i rregullojnë format e shuarjes së martesës (neni 59-98). Pjesa e katërt rregullon marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve (neni 99-155). Pjesa e pestë rregullon format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror (neni 156-214). Pjesa e gjashtë, rregullon kujdestarinë (neni 215-270). Pjesa e shtatë, rregullon marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare (neni 271- 277). Pjesa e tetë, rregullon mbajtjen financiare (neni 278-355), detyrimi ligjor i mbajtjes midis anëtarëve të familjes (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006).

KAPITULLI I DYTË

2. ZGJIDHJA E MARTESËS DHE PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT

2.1. E drejta martesore, objekti dhe subjekti

E drejta martesore si pjesë përbërëse e shkencës juridike mbi të drejtën familjare përfshinë tërësinë e studimeve, që i referohet rregullimit juridik të martesës dhe marrëdhënieve martesore (Selmani & Rexhepi, 2014, fq.194). Normat juridike të cilat i përfshinë e drejta martesore, janë kryesisht të natyrës urdhëruese mirëpo ka edhe marrëdhënie martesore të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv (Podvorica, 2006, fq. 59). Me norma të natyrës urdhëruese rregullohet forma e lidhjes së martesës, zgjidhja e martesës, marrëdhëniet pasurore juridike, por edhe marrëdhënie të tjera të rëndësishme nga sfera e jetës së bashkëshortore. Ndërsa, me norma te karakterit dispozitiv rregullohen marrëdhëniet martesore të cilat përfshijnë marrëveshje të bashkëshortëve, qoftë për mbiemër, vendbanim etj (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Në Republikën e Kosovës marrëdhëniet martesore janë të rregulluara me Ligjin për Familjen (Gazeta Zyrtare e Kosovës, Nr.2004/32).

a) Objekti i së Drejtës Martesore

Objekt i rregullimit të së drejtës martesore janë martesa dhe marrëdhëniet martesore që studion:

- 4.** lidhjen e martesës,
- 5.** kushtet dhe procedurat,
- 6.** efektet juridike,
- 7.** pavlefshmërinë e martesës,
- 8.** mënyrën e zgjidhjes së martesës,
- 9.** shkaqet e anulimit,
- 10.** të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve gjatë martesës,
- 11.** marrëdhëniet tjera të ndërlidhura me martesën (Zace, 2016).

Në martesë ekzistojnë edhe marrëdhënie të karakterit moral ose natyror në mes të bashkëshortëve të cilat nuk mund të rregullohen me dispozita ligjore, por të cilat rregullohen me norma morale (Oruci, 1994).

2.2. Parimet Themelore të së Drejtës Martesore

Të drejtat martesore dhe parimet themelore të saj janë të garantuara me Kushtetutë (si akti juridik më i lartë i një vendi) dhe mosrespektimi i tyre shkakton pavlefshmërinë e martesës së lidhur. Parimet themelore të së drejtës martesore janë: parimi i barazisë, parimi i laicitetit, parimi i institucionalitetit, parimi i monogamisë dhe parimi i jetës së vazhdueshme (Podvorica, 2005).

Parimi i Barazisë - me shprehje pozitive burrit ka qenë dominuese dhe ka ushtruar pabarazi në pozitën e gruas. Gruaja nuk gëzonte pushtet të plotë mbi integritetin, autoritetin, rolin e saj si grua dhe mbi pasurinë e saj, ajo ishte e diskriminuar nga burri. Ky fenomen zanafillën e theksuar e ka që nga e drejta romake. Që nga ndryshimet e mëdha në të drejtën familjare, roli i gruas në familje dhe në shoqëri ka pasur evolucion. E drejta martesore dhe zgjidhja e saj është e rregulluar sipas Ligjit për Familjen të Kosovës, sipas nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 thot :

- “Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes” (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, fq. 6).
- “Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj” (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, fq.6).

Mos respektimi i këtyre dispozitave shkakton problem dhe çrregullime në marrëdhënien martesore, që mund të jenë arsye për zgjidhjen e martesës (Podvorica, 2006).

Parimi i Laicitetit - Forma civile e lidhjes së martesës është detyruese, kjo është e rregulluar edhe me nenin 28 të Ligjit për Familjen të Kosovës, citoj:

- Për të lidhur martesë është e nevojshme që dy persona të gjinisë së kundërt, në prani të të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë përpara ofiqarit,
- Deklarata duhet të jetë e pakushtëzuar dhe e menjëhershme.
- Palët pjesëmarrëse gjatë lidhjes së martesës janë bashkëshortët, dy dëshmitarë dhe ofiqari,
- Secili person me aftësi për të vepruar mund të jetë dëshmitar gjatë lidhjes së martesës (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, fq. 11).

Arsyet për zbatimin e kësaj dispozite mundëson eliminimin e normave kanonike në të drejtën martesore dhe të gjykatave të shenjta për gjykimin e kontesteve martesore (Podvorica, 2006, fq. 63).

Parimi i Institucionit - Martesa konsiderohet institucion shoqëror me karakter dhe interes të përgjithshëm shoqëror e cila është e rregulluar me dispozita ligjore. Mbrojtje juridike gëzon martesa civile e cila është lidhur para ofiqarit. Kontestet martesore dhe marrëdhëniet martesore gjykohen nga gjykatat e rregullta, që do të thotë se çdo subjekt që është pjesëtar i marrëdhënies martesore gëzon mbrojtje juridike (Podvorica, 2006, fq.64).

Parimi i Monogamisë - Me monogami kuptohet bashkëjetesa ose martesa e një burri vetëm me një grua. (FJALË Fjalor Shqip, n.d.) Ky parim është i paraparë në Ligjin për Familjen të RK-së, ku citon:

“Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes” (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 14).

Sipas këtij parimi, martesa e dytë nuk mund të lidhet në qoftë se ekziston ende martesa e parë. Ekzistimi i martesës është pengesë absolute martesore. Kjo është e sanksionuar edhe me Kodin

Penal të Kosovës neni 205 ku parashihet dënimi me burg në kohëzgjatje deri në një vit për personin i cili lidhë martesë të re derisa është në martesë të vlefshme me një person tjetër.

Parimi i Vazhdimësisë së jetës martesore - Martesa nuk mund të kufizohet në pikëpamje kohore. Ajo zgjatë, aq sa zgjatë jeta e bashkëshorteve apo marrëdhëniet martesore brenda bashkëshortëve (Podvorica, 2006, fq. 65). Ky parim mbështetet në faktin se martesa lidhet si akt juridik, pa afat të kufizuar në kohëzgjatje dhe mund të shkëputet për arsye të cekura në ligj. Kufizimi i saj në pikëpamje kohore do të ishte në kundërshtim me institutin e martesës. Martesa e lidhur me afat, me ndonjë qëllim tjetër nuk është e vlefshme (Podvorica, 2006). Martesa lidhet si rezultat i ndjenjës së dashurisë, respektit. Mirëpo shpesh herë marrëdhëniet martesore çrregullohen dhe shkaktojnë konflikt të brendshëm martesor që shpijnë drejtë zgjidhjes së martesës së vlefshme; shkurorëzimit (Podvorica, 2006, fq.66).

2.3. Kuptimi, llojet e të drejtave dhe detyrimet e bashkëshortëve

Martesa si institucion juridik dhe shoqëror krijon të drejta dhe detyrime reciproke në mes të bashkëshortëve. Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve ndahen:

- Të drejtat dhe detyrat personale për cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje; dhe
- Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

Të drejtat dhe detyrat personale për cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje - në këtë grupim bëjnë pjesë të drejtat personale të rregulluara me normat ligjore urdhëruese, si: jetesa e përbashkët e bashkëshortëve; barazia e bashkëshortëve; pavarësia e bashkëshortëve në zgjedhjen e punës e të profesionit; besnikëria bashkëshortore dhe ndihma reciproke midis bashkëshortëve (Podvorica, 2006, fq. 102).

- **Jetesa e përbashkët e bashkëshortëve** - është një ndër qëllimet kryesore për krijimin e martesës, sepse pa jetë të përbashkët bashkëshortore nuk mund të lindin të drejtat dhe detyrimet në mes të gruas dhe burrit (Neni 42, LFK).
 - **Barazia e bashkëshortëve** - Bashkëshortët në martesë janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore (Neni 42, LFK).
 - **Pavarësia e bashkëshortëve për të zgjidhura punës dhe profesionin** - Kjo do të thotë se bashkëshortët kanë të drejtë dhe mundësi të zgjedhin profesionin e tyre dhe punën, ku do ushtrojnë vullnetin e tyre të lirë në punë pavarësisht nëse bashkëshortit tjetër nuk i pëlqen. Me këtë kuptohet që me forcën e ligjit ndalohet diskriminimi i gruas në aspektin e punës dhe profesionit, fenomen i cili ka zgjatur me shekuj në botë (Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", 2020).
 - **Detyrimi i ndihmës dhe i respektimi** - Bashkëshortët kanë për obligim moral dhe material t'i ofrojnë mbështetje emocionale dhe morale njëri tjetrit. Respekti në raport bashkëshortor luan një ndër funksionet më të rëndësishme që një martesë të jetë e lumtur dhe afatgjatë.
 - **Besnikëria bashkëshortore** - Bashkëshortët kanë detyrë për t'i qëndruar besnik njëri - tjetrit (Podvorica, 2006, fq. 105). Shkelja e besnikërisë në marrëdhënie bashkëshortore sanksionohet vetëm me zgjidhjen e martesës (shkurorëzim). Kjo parashihet edhe në nenin 69 të LFK-së paragrafi 2 ku ndër arsytet tjera edhe shkeljen e besnikërisë bashkëshortore e konsideron si shkak për shkurorëzim.
- Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje** - në këtë grup bëjnë pjesë të drejtat dhe detyrimet me karakter dispozitiv, që do të thotë se bashkëshortët mund t'i rregullojnë raportet martesore sipas marrëveshjes si: caktimi i mbiemrit, caktimi i vendbanimit, lindja e fëmijëve, ekonomia e përbashkët familjare, caktimi i shtetësisë (Podvorica, 2006, fq. 106).
- **Caktimi i mbiemrit** -Sipas nenit 43 të LFK-së, citoj: “Bashkëshortët duhet të caktojnë mbiemrin e tyre të përbashkët (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 43).

Me rastin e lidhjes së martesës, bashkëshortët me marrëveshje mund të vendosin: që secili ta mbajë mbiemrin e vet; që i përbashkët të jetë mbiemri i njërit prej bashkëshortëve; që t'ia bashkëngjisin mbiemrin e vet mbiemrit të njërit prej bashkëshortëve. Kombinimi i mbiemrit nuk do të jetë i mundur, nëse mbiemrat e bashkëshortëve tanimë përbëhen nga mbiemri i dyfishtë. Në rast të tillë vetëm njeri nga mbiemrat mund të kombinohet me emrin e bashkëshortit tjetër dhe të bëhet mbiemër martesor. Në rast se bashkëshortët nuk vendosin lidhur me mbiemrin martesor, secili prej tyre mban mbiemrin e vet.

b) Caktimi i Vendbanimit dhe c) Ekonomia e përbashkët familjare janë të rregulluara në nenin 44 të LFK-së paragrafi 1, 2 ,3.

- Bashkëshortët vendosin për vendin e banimit dhe për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare me marrëveshje (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 44).
- Në rast se njëri nga bashkëshortët është përgjegjës për mirëmbajtjen e shtëpisë, ai udhëheq shtëpinë në përgjegjësinë vetanake por që të dy bashkëshortët kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes në proporcion me aftësitë e tyre individuale (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 44) .

2.4. Zgjidhja e martesës

Martesa e lidhur edhe mund të zgjidhet. Lidhja e martesës dhe zgjidhja rregullohet me ligj, mënyrat e shuarjes së martesës parashihen në nenin 60, paragrafi 1, të LFK-së. Martesa shuhet me vdekjen e bashkëshortit, shpalljen e bashkëshortit të zhdukur të vdekur, anulimit dhe shkurorëzimit (Neni 60, LFK). Martesa zgjidhet vetëm pas parashtrimit të padis dhe me vendim të gjykatës përmes anulimit (martesa e pavlefshme) ose zgjidhjes (shkurorëzimit). Anulimi ose shkurorëzimi prodhojnë efekte juridike kur aktgjykimi i gjykatës për anulimin ose shkurorëzimin e martesës marrin formën e prerë (Neni 60, LFK, par.3).

a) Zgjidhja e martesës me vdekjen e njërit bashkëshort

Me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, martesë pushon (Neni 60, par.1, LFK). Vdekja është një fakt juridik me paraqitjen e të cilit sipas fuqisë së ligjit pushon martesë e vlefshme (Zendeli et al., 2020, fq. 157). Kjo është mënyra natyrore e zgjidhjes së martesës. Nga momenti i vdekjes së njërit nga bashkëshortët, ai regjistrohet në librat amzë të të vdekurve. Nga ai moment pushon subjektiviteti juridik i bashkëshortit të vdekur, të drejtat dhe detyrimet në raport me të bashkëshortëve. Në këtë rast kemi të bëjmë me mënyrën e pushimit të martesës së plotfuqishme pasi që martesë nuk ka nevojë të zgjidhet me anë të marrëveshjes apo me anulim të saj, sepse ajo konsiderohet e zgjidhur në momentin e vdekjes së njërit nga bashkëshortët. Kur bashkëshorti i zhdukur shpallet i vdekur, martesë zgjidhet në ditën kur vdekja e bashkëshortit të zhdukur arrihet me aktvendimin e formës së prerë.

Zgjidhja e martesës në rast të vdekjes së bashkëshortit prodhon disa efekte juridike lidhur me: a) çështjen statusore; b) mbiemrin martesor, c) trashëgiminë dhe q) pjesëtimin e pasurisë së përbashkët (Mulaj, 2011, fq.4).

b) Zgjidhja e martesës me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur

Person i zhdukur konsiderohet personi i cili nuk dihet se ku gjendet në kohët e fundit. Quhet i zhdukur ai person, të cilit nuk i dihet as vendbanimi as vendqëndrimi, ndërsa në bazë të rrethanave të rastit besohet se ka vdekur. Martesë mund të zgjidhet me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur (Neni 60, par.1, LFK). Vetëm zhdukja nuk mjafton për mbarimin e një martesë (Podvorica, 2006, 112). Zgjidhja e martesës pas zhdukjes së njërit bashkëshort, parashihet në nenin 60, paragrafi i 4 i LFK-së kur bashkëshorti i zhdukur shpallet i vdekur. Martesë zgjidhet në ditën kur vdekja e bashkëshortit të zhdukur arrihet me aktvendim të formës së prerë. Në momentin e marrjes së këtij aktvendimi, martesë mbaron dhe nga ai moment bashkëshorti ka të drejtë të lidhë martesë të re pasi që të drejtat dhe detyrimet në mes të bashkëshortëve të mëparshëm mbarojnë.

Fillimisht që kjo procedurë të jetë e plotfuqishme duhet që të plotësohen disa kushte të cilat janë paraparë në nenin 57 të Ligjit Nr.03/L-07, për Procedurën Jokontestimore të Kosovës, sipas së cilës vendimi i gjykatës për një person të zhdukur i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes cilëve, në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikimi i tij në Gazetë Zyrtare apo ndonjë gazetë të përditshme të caktuar sipas dispozitave të nenit 56 të këtij ligji. (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008, neni 57)

Propozimin për fillim e procedurës mund ta paraqesë bashkëshorti i gjallë i personit të zhdukur, të gjithë personat që kanë interes juridik drejtpërdrejtë dhe prokurori publik. (Podvorica, 2006, fq.112)

c) Zgjidhja e martesës me anulim dhe shkurorëzim

Martesa zgjidhet me anulim, kur aktgjykimi i gjykatës merr formën e prerë. Martesa e lidhur mundet të jetë edhe e pavlefshme. Cilësohet e pavlefshme një martesë e cila nuk i ka përmbushur kushtet e parapara në dispozitat ligjore për plotfuqishmërinë e saj (Podvorica, 2006, fq.114). Në ligj janë paraparë të gjitha shkaqet për anulimin e martesës në dispozitat e neneve 60-67 të Ligjit të Familjes së Kosovës. Që një martesë të jetë e plotfuqishme ajo duhet që të jetë e lidhur në mënyrat e parapara në ligj. Mos-respektimi i kushteve të parapara në ligj shkakton edhe anulimin e martesës. Anulimi i martesës shkakton pasoja edhe juridike prej ditës së anulimit të saj me aktgjykim të formës së plotfuqishme.

Martesa e pavlefshme ndahet në:

- *Zgjidhje e martesës me anulim për shkaqe absolute,*
- *Zgjidhje e martesës me anulim për shkaqe relative. (Podvirca, 2006, fq. 123)*

d) Zgjidhja e martesës me anulim për shkaqe absolute - Sipas teorisë juridike, por edhe përmbajtës së dispozitave ligjore të LFK neneve 62-67, me të cilat është rregulluar anulimi i martesës, si shkaqe të anulimit absolut mund të numërohen:

- a) Martesa ekzistuese;
- b) Aftësia për të vepruar;

- c) Mosrespektimi i dallimit të sekseve;
- d) Gjinia (e gjakut, krushqisë, dhe adoptimit);
- e) Lidhja e martesës para moshës 16 vjeçare;
- f) Mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës,
- g) Shmangia nga qëllimi i martesës. (Ariu & Gashi, 2007, fq.151)

Martesat absolute të pavlefshme konsiderohen martesat që janë lidhur në kundërshtim me kushtet e parapara ligjore për lidhjen e martesës. Të drejtë për padi në anulimin e martesës kanë: prokurori publik, bashkëshortët dhe çdo person tjetër që ka interes juridik.

e) Zgjidhja e martesës me anulimin për shkaqe relative - Nga përmbajtja e ligjit dhe nga efektet juridike të disa shkaqeve, mund të përfundohet se shkaqe të nulitetit relativ të martesës janë:

- a) *Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë;*
- b) *Lidhja e martesës nën moshën 18 vjeçare;*
- c) *Paaftësia për të vepruar (Aliu & Gashi, 2007).*

a) ***Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë*** - Një martesë konsiderohet e pavlefshme nëse të dy bashkëshortët janë lidhur pa vullnetin e tyre, nëse deklarimin njëri apo të dy bashkëshortët e kanë bërë për shkak të përdorimit të dhunës ndaj tyre, kërcënimit, mashtrimit apo të lajthimit. Mirëpo, në kohët e sotme ky shkak po ndodh më rrallë, shkak që mënyra formale e lidhjes së martesës po manifestohet para nëpunësit (ofiqarit) të gjendjes civile, dy dëshmitarëve dhe formës solemne të saj. Kjo është e paraparë edhe në nenin 31 të LFK-së. Në doktrinën juridike njihen shkaqet e anulimit relativ të martesës si: dhuna, lajthitja, mashtrimi, mituria, sëmundja psikike dhe pazotësia e veprimit e paraqitur gjatë martesës (Mulaj, 2011, fq. 16).

b) ***Lidhja e martesës nën moshën 18 vjet-*** Kjo lidhje e martesës mund të lejohet vetëm në disa raste të caktuara, si p.sh.; me vendim të gjykatës mund të lejohet lidhja e martesës

së personave prej moshës 16-18 vjet. Martesa e lidhur nën moshën 18 vjet është e pavlefshme, përveç nëse është dhënë leja nga gjykata për t'u lidhur martesa (Aliu & Gashi, 2007, fq.156).

- c) **Paaftësia për të vepruar** - Paaftësia për të vepruar është shkak për nulitetin relativ të martesës, nëse ka pushuar gjatë ekzistimit të martesës (Aliu & Gashi, 2007, fq.156). Nëse bashkëshorti nuk ka pasur njohuri gjatë lidhjes së martesës për ekzistimin e paaftësisë për të vepruar të bashkëshortit, ai vendos se a do të paraqesë padi lidhur me anulimin e martesës apo jo (Neni 67, LFK). Në qoftë se bashkëshorti nuk paraqet padi për anulim të martesës, atëherë martesa mbetet në fuqi.

2.4.1. Shkurorëzimi si mënyrë e zgjidhjes së martesës

Martesa mund të lidhet dhe zgjidhet me vullnetin e bashkëshortëve. Kjo marrëdhënie bashkëshortore kur arrin të bëhet e pamundur dhe e padurueshme jeta e përbashkët lejohet shkurorëzimi i martesës (Zendeli et al., 2020, fq. 159). Të dy bashkëshortët apo vetëm gruaja ose burri mund të shprehin dëshirën e tyre për të zgjidhur martesën. Kjo zgjidhje e martesës së vlefshme realizohet përmes shkurorëzimit, e cila është e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacenueshme e çdo individi. Shkurorëzimi i martesës paraqet mënyrën e vlefshme të zgjidhjes së martesës së vlefshme në kohën e jetesës së bashkëshortëve me vendim të gjyqit, përderisa janë përmbushur shkaqet e parapara me ligj. Pra, shkurorëzimi prodhon efekte juridike, kur aktgjykimi për anulim apo shkurorëzimin e martesës, merr formën e prerë. (Ligji për Familjen, 2006, neni 60, par.2, fq.12).

Martesa duhet të lidhet sipas mënyrës së paraparë me ligj. Mos-respektimi i kushteve të parapara me ligj, ka si pasojë pavlefshmërinë e martesës (Aliu & Gashi, 2007, fq. 150). Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim përmes padis private të ngritur nga bashkëshorti ose bashkëshortët, ku procedura e saj zhvillohet në Gjykatën Kompetente (Aliu & Gashi, 2007).

Veçorit kryesore të shkurorëzimit të martesës janë:

- *Martesa e vlefshme zgjidhet në mënyrë juridike,*
- *Martesa zgjidhet gjatë jetesës së përbashkët,*
- *Gjykata, si organ shtetëror merr vendimin (aktgjykimin) për shkurorëzim,*
- *Shkaqet e shkurorëzimit të martesës duhet të jenë të parapara me ligj (Aliu & Gashi, 2007, fq.150).*

Martesa e vlefshme zgjidhet në mënyrën juridike

- Ekzistimi i martesës së vlefshme zgjidhet përmes shkurorëzimit, ndërsa martesat e pavlefshme me anë të anulimit (Mulaj, 2011, fq.21). Në qoftë se njëjtën kohë ekzistojnë edhe shkaqet e anulimit por edhe shkaqet e shkurorëzimit, së pari diskutohen arsyet e anulimit dhe pastaj zhvillohet procedura e anulimit të martesës. Nga kjo kuptohet që askush nuk mund të lidhë martesë në kundërshtim me ligjin. Prandaj shkaqet e anulimit kanë përparësi ligjore në raport me shkaqet e shkurorëzimit, sepse vetëm martesa e vlefshme mund të zgjidhet më shkurorëzim (Aliu & Gashi, 2007, fq. 159).

Martesa zgjidhet gjatë jetesës së përbashkët

- Shkurorëzimi mundësohet gjatë jetës së përbashkët të bashkëshortëve d.m.th.sa të jenë gjallë, sepse pas vdekjes martesa pushon në mënyre natyrore (Mulaj, 2011). Bashkëshortët duhet të jenë gjallë gjatë gjithë procedurës së shkurorëzimit, prej dorëzimit të padisë deri në plotfuqishmërinë e vendimit për shkurorëzim të martesës. Me vdekjen e njërit bashkëshort martesa përfundon sipas fuqisë së ligjit (EX OFFICIO), sepse procedura e shkurorëzimit ndërpritet (Azizi, 2020, fq.16).

Gjykata si organ shtetëror - merr vendim (aktgjykimin) për shkurorëzim

- Martesa është një institut shoqëror i mbrojtur me ligj nga shteti (Mulaj, 2011, fq. 22). Ajo lidhet me shprehjen e lirë të vullnetit të bashkëshortëve, si rezultat a shprehje e

ndjenjës së dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok (Podvorica, 2006, fq.66). Mirëpo edhe pse kjo martesë është lidhur me anë të vullnetit të bashkëshortëve ajo mund të zgjidhet kur bashkëshortët kërkojnë zgjidhjen e saj. Gjykata fillimisht e vlerëson se a e ka humbur martesa dashurinë dhe respektin (si koncepte shumë të rëndësishme të saj). Në rast se ajo vlerëson se martesa ka humbur funksionin e saj, ajo zgjidhet me aktgjykim të Gjykatës Themelore. Në këtë rast arrihet të kuptohet se dispozitat ligjore për rregullimin e martesës janë të natyrës urdhëruese dhe bashkëshortët këto dispozita nuk mund t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre, me qëllim të ruajtjes së martesës (Mulaj, 2011, fq.22).

Shkaqet e shkurorëzimit të martesës duhet të jenë të parapara me ligj

Shumë herë martesa si bashkëjetesë e dy çifteve të lumtura merr kahe tjetër. Jeta e tyre arrin deri në atë pikë sa bëhet e padurueshme, ku i vetmi opsion për ta është zgjidhja e martesës me shkurorëzim. Martesa nuk mund të shkurorëzohet pa ekzistimin e shkaqeve të parapara me ligj. Sipas nenit 69, paragrafi 1 dhe 2 të LFK-së parashihet se, bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë të çrregulluara seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pa kthyeshme (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 69).

Ligji për Familje ka listuar këto shkaqe të shkurorëzimit: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, keqtrajtimi serioz, lënia e qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme (Neni 69, LFK).

Procedura për zgjidhjen e martesës duhet po ashtu të jetë e paraparë me ligj

Në Kosovë, procedura e shkurorëzimit është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Familjen të Kosovës . Sipas LFK-së, neni 68, paragrafi 1, martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm

në bazë të vendimit (aktgjykimit) të gjykatës kompetente (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 68). Në shumicën e shteteve procedura për zgjidhjen e martesës është e rregulluar me Ligjin për Familjen (Mulaj, 2011, fq. 23).

2.5. Shkaqet e shkurorëzimit

Shkaqet e shkurorëzimit janë fakte dhe rrethana që lindin pas lidhjes së martesës, për të cilat mund të kërkohet zgjidhja e saj. Shkaqet më rëndësishme janë:

- *Shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta,*
- *Shkaqet absolute dhe relative,*
- *Shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit, shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit, shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me afat,*
- *Shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta të zgjidhjes së martesës,*
- *Shkaqet për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit (Podvorica, 2006, fq. 122).*

Shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta

- **Shkaqet e përgjithshme** - të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim janë rrethana dhe fakte që ndodhin gjatë martesës të cilat çrregullojnë marrëdhënien martesore deri në atë masë sa jeta e përbashkët martesore është e pamundur dhe e padurueshme (Podvorica, 2006, fq.122). Marrëdhëniet martesore çrregullohen zakonisht kur shkelen detyrimet martesore qoftë prej njërit apo prej të dy bashkëshortëve. (Podvorica, 2006, fq.122)
- **Shkaqet e veçanta** - të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim janë paraparë me Ligjin për Familjen të Republikës së Kosovës, neni 69, paragrafi 2, i cili i ka rregulluar në detaje shkaqet e veçanta për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim:

- *Jeta e padurueshme e bashkëshortëve,*
- *Shkelja e besnikërisë bashkëshortore,*
- *Veprat penale kundër jetës së bashkëshortit,*
- *Keqtrajtimi serioz,*
- *Lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme,*
- *Sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar,*
- *Ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 69).*
-

c) Shkaqet absolute dhe relative

- **Shkaqet Absolute** - janë fakte dhe rrethana të përcaktuara me norma ligjore si shkelje e detyrimeve martesore nga bashkëshortët, ku në vetvete kanë fuqinë e shkakut shkurorëzues. (Podvorica, 2006 & Mulaj, 2011). Për shembull: shkelja e besnikërisë bashkëshortore; veprat penale kundër jetës së bashkëshortit; keqtrajtimi serioz; sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, etj. (Mulaj, 2011, fq.49).
- **Shkaqet Relative** - të zgjidhjes së martesës janë shkaqe që gjykata ka detyrë t'i vërtetojë detyrimisht në çdo rast konkret, nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar sa jetën e mëtutjeshme bashkëshortore e kan bërë të pamundshme, këto shkaqe janë të shumta dhe të llojllojshme si: dallimi në moshë, xhelozia, karakteret e ndryshme, etj. (Mulaj, 2011, fq.49).

c) Shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit, shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit, shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me afat;

- Ekzistojnë raste kur padia nuk mund të parashtrohet para se të kalojë afati i përcaktuar me ligj. Sipas nenit 70 të LFK-së, paragrafi 1: Bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t'i ketë

mbushur një vit (Neni 70, LFK). Qëllimi kryesor që është paraparë me këtë ligj është që të mbrohen interesat ndaj fëmijëve të mitur, të përbashkët. Padia mund të paraqitet me lindjen e shkakut, ndërsa e drejta në padi nuk mund të parashkruhet me kalimin e një intervali kohor (Podvorica, 2006, fq. 124).

d) Shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta të zgjidhjes së martesës

- **Shkaqet e fshehta të zgjidhjes së martesës** - janë veprime të fshehta që në momentin e lidhjes së martesës dhe si të tilla janë mbajtur të fshehta me qëllim që t'i shkaktojë ndonjë të keqe bashkëshortit tjetër, si p.sh. Shkaktimi i ndonjë sulmi kundër jetës ose shëndetit të bashkëshortit tjetër.
- **Shkaqet jo të fshehta të zgjidhjes së martesës** - janë veprime jo të fshehta me qëllim jo të keq, si p.sh: karaktere të kundërta dhe të mos-përputhshme, sëmundja psikike etj. (Podvorica, 2006, fq. 125)

e) Shkaqet për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit

- **Shkaqet për zgjidhjen e martesës që pas kalimit, të afatit të caktuar në ligj humbet e drejta e padisë** - janë të natyrës relative. Në paraqitjen e tyre qëndron fajësia si element subjektiv. Të tilla janë lënia qëllimkeqe dhe pa arsye e bashkëshortit tjetër, shkelja e besnikërisë martesore etj. (Podvorica, 2006, fq.125).
- **Shkaqet për zgjidhjen e martesës që nuk humbet e drejta e padisë pas kalimit të afatit** - janë të natyrës objektive. E drejta e padisë nuk parashkruhet, veçse ajo mund të ngrihet në çdo kohë pas lindjes së shkakut për zgjidhje të martesës. (Podvorica, 2006, fq.125)

2.6. Procedurat e shkurorëzimit

Procedura e shkurorëzimit është e veçantë për dallim nga procedurat tjera për arsye se marrëdhëniet të cilat rregullohen në kontestet martesore kanë karakter të natyrës personale (intuitu personae) dhe kjo i bën që të dallohen nga marrëdhëniet pronësore. Karakteristika e dytë ka të bëjë me faktin se martesa është institucion shoqëror dhe juridik (Podvorica, 2006, fq.128). Për këtë shkak ajo rregullohet me norma urdhëruese ligjore dhe me anë të saj shoqëria synon realizimin e qëllimeve konkrete (Podvorica, 2006, fq.58). Kushti kryesor për fillimin e procedurës së zgjidhjes së martesës me shkurorëzim është propozimi për shkurorëzim me marrëveshje apo me padi. Pas paraqitjes së propozimit me marrëveshje apo padi, gjykata merr aktgjykim për zgjidhjen martesës me shkurorëzim, e cila vlerëson se a janë paraparë kushtet për të marrë aktgjykim. Këto kushte janë të parapara në të drejtën materiale (Mulaj, 2011, fq. 58). Në rast të mungesës së dispozitave të veçanta për zgjidhjen e kontesteve martesore, zbatohen dispozitat e procedurës civile (Ligji për familjen, 2006, neni 349).

Parimet e procedurës së shkurorëzimit janë:

- *Parimi i barabarësisë së bashkëshortëve;*
- *Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë;*
- *Parimi i përjashtimit të publikut;*
- *Parimi i oficalitetit;*
- *Parimi i dispozicitetit;*
- *Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit (Mulaj, 2011, fq.59).*

2.7. Pasojat juridike të shkurorëzimit

Me lidhjen e martesës krijohen të drejta dhe detyrime në mes të bashkëshortëve, ndërsa me zgjidhjen e martesës paraqiten pasoja juridike të natyrës personale juridike dhe të

natyrës pasurore. Pasoja personale ndahen në: pasojat juridike personale për bashkëshortët dhe pasojat juridike personale për fëmijët e përbashkët (Podvorica, 2006, fq.135). Pasojat juridike për zgjidhjen e martesës të bashkëshortëve janë: mbiemri, ndarja e pronës së përbashkët, kthimi i dhuratave, detyrimi i ushqimit, e drejta e banesës, trashëgimia ligjore dhe testamentare, pasojat juridike të zgjidhjes së martesës për fëmijët e mitur të përbashkët, pasojat juridike të zgjidhjes së martesës për fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martese. (Mulaj, 2011, fq.75). Ndërsa pasojat juridike për fëmijë janë të lidhura me: besimin, ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijës, kujdesin ndaj tyre.

Në rastet kur bashkëshortët përmes zgjidhjes së martesës nuk janë dakorduar rreth interesit të fëmijëve atëherë gjykata vendos me aktgjykim lidhur me interesat e fëmijëve ndaj prindërve. Aktgjykimi i gjykatës gjithashtu duhet të përmbajë njërin prej këtyre vendimeve:


- të gjithë fëmijët mund t'i besohen në ruajtje dhe mbrojtje njërit prindër;
- që fëmijët të ndahen, ashtu që një apo më shumë prej tyre t'i besohen nënës dhe një apo më shumë babait, dhe
- që t'i besohen një personi të tretë apo ndonjë institucioni tjetër.

Me rastin e vendosjes për besimin e fëmijëve në ruajtje dhe mbajtje, gjykata në mënyrë ekskluzive do të ketë kujdes për interesin e fëmijëve, pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë me rastin e zgjidhjes së martesës (Podvorica, 2006, fq. 139).


2.8. Praktika juridike

Në këtë pjesë paraqiten të dhëna statistikore lidhur me numrin e shkurorëzimeve, përmes grafikoneve të nxjerra nga Gjykatat Themelore në Kosovë për periudhën kohore 2012-2016:


Grafiku 1. Lëndët e pranura në gjykatë sipas vitit 2012-2016




Grafiku 2. Lëndët e zgjidhura sipas viteve 2012-2016




Grafiku 3. Lëndët e pazgjedhura të shkurorëzimit për vitin 2012-2016



Grafiku 4. Lëndët e zgjidhura me marrëveshje të bashkëshortëve 2012-2016



Grafiku 5. Lëndët e zgjedhura me tërheqjen e padis për shkurorëzim viti 2012-2016



KAPITULLI 3

3. PASOJAT JURIDIKE PASURORE TË SHKURORËZIMIT

3.1. Pasojat juridike të zgjidhjes martesore

Marrëdhëniet juridike të cilat janë krijuar gjatë bashkësisë martesore, me zgjidhjen e saj paraqiten pasojat të caktuara juridike të cilat kanë të bëjnë me shuarjen, ndryshimin apo krijimin e marrëdhënie juridike në mes të ish-bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës janë:

- a) *Pasojat juridike personale të zgjidhjes së martesës për bashkëshortët,*
- b) *Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës për fëmijët e mitur të përbashkët. (Valbon Mulaj, Zgjidhja e martesës, 75).*

Në grupin e pasojave personale juridike për zgjidhjen e martesës së bashkëshortëve, bëjnë pjesë: *mbiemri; ndarja e pronës së përbashkët; kthimi i dhuratave; detyrimi i ushqimit; e drejta e banesës; e drejta e trashëgimit dhe pasojat për fëmijë (Hamdi Podvorica, E drejta familjare, 135).*

Të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve martesorë, pavarësisht karakterit, përmbajtjes, elementit që ato kanë ndahen në dy grupe: pasojat juridike personale dhe pasojat juridike pasurore (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 141). Përmes lidhjes së martesës, bashkëshortët hyjnë në raportet personale dhe pasurore ku Ligji i Kosovës për Familjen, parasheh se në këto raporte, bashkëshortët janë të barabartë. Në raportet pasurore, pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë dhe e përbashkët. Pas shkukurorëzimit të martesës, pasuria e përbashkët mund të ndahet me marrëveshjen e bashkëshortëve (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 45). Nëse bashkëshortët nuk pajtohen, ndarja e pasurisë së përbashkët bëhet në procedurë kontestimore pranë gjykatës kompetente. Bashkëshortët që jetojnë në bashkësi martesore krijojnë të mira materiale; si krijimi i pasurisë për të përmbushur nevojat e veta për mbijetesë (Podvorica, 2006, fq. 239). Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjim pasuror martesor

(Podvorica, 2006, fq.239). Marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve janë paraparë në nenet 45-57 sipas Ligjit për Familjën të Kosovës.

Ekzistojnë disa regjime pasurore:

- a) Regjimi i pasurisë së veçantë;**
- b) Regjimi i pasurisë së përbashkët; dhe**
- c) Regjimi i përzier.**

a) Regjimi i pasurisë së veçantë - Pronari i të drejtës së pronësisë së veçantë posedon dhe menaxhon pronësinë e tij në mënyrë të pavarur nga bashkëshorti. Pasuria e veçantë është pasuri e fituar para lidhjes apo krijimit të martesës, pronari i saj nuk e ka fituar me punë gjatë jetesës bashkëshortore.

b) Regjimi i pasurisë së përbashkët - Pronarë të së drejtës së pronësisë së përbashkët e posedojnë dhe e menaxhojnë bashkëshortët së bashku, pasi që ajo pasuri është krijuar gjatë lidhjes së fitimit apo krijimit të martesës (Podvorica, 2006, fq.240).

c) Regjimi i përzier - Përfshinë elemente të regjimit të pasurisë së veçantë dhe të pasurisë së veçantë, por edhe të pasurisë së përbashkët. Me reformat e reja barazia e bashkëshortëve vjen në radhë të parë, ku qëllimi i saj është që të bëhet realizimi i barabartë i të drejtave të bashkëshortëve lidhur me administrimin dhe disponimin e pronësisë në mënyrë të barabartë (Podvorica, 2006, fq.240).

3.2. Llojet e pasurisë së bashkëshortëve

3.2.1. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve

Pasuria e veçantë është ajo pasuri të cilën çifti bashkëshortor e ka pasur në momentin e lidhjes së martesës, si dhe pasuria të cilën e ka fituar gjatë bashkësisë martesore në çfarëdo mënyre të lejuar ligjore, por jo me punë (Podvorica, 2006, fq. 240). Pasuria e veçantë është

pasuria e fituar gjatë bashkësisë martesore e fituar me trashëgimit, punës apo pronës intelektuale apo kur pasuria e krijuar nga njëri bashkëshort i cili faktikisht nuk ka jetuar në bashkësi martesore është krijuar me kontributin e tij personal. Karakteristikat e pasurisë së veçantë është se secili bashkëshortë e administron dhe e posedon pronësinë e tij në mënyrë të pavarur gjatë gjithë kohës së martesës (Neni 46, LFK).

3.2.2. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Pronësia e përbashkët të bashkëshortëve rregullohet me dispozitat e LFK-së dhe më dispozitat e Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera të Kosovës. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve është e drejta e pronësisë që e kanë dy apo më shumë persona mbi të njëjtin sendin, por që pjesët e tyre nuk janë të përcaktuara, dhe nuk mund të disponojnë me to në mënyrë të pavarur, deri sa të zgjasë gjendja e pronësisë së përbashkët (Aliu, 2014, fq.121). Sipas LPTDS-së Kosovës, pronësia e përbashkët mund të krijohet sipas ligjit ose përmes kontratës, “Marrëveshja me të cilën krijohet pronësia e përbashkët mund të lidhet vetëm nëse shprehimisht është e lejuar me ligj.”(ligjin). Në këtë rast, martesë është kontratë civile dhe institucion juridik (Podvorica, 2006, fq.67). Sipas nenit 47 të LFK-së, pasuria e përbashkët bashkëshortore është pasuri e fituar me punë gjatë vazhimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, Neni 47, par. 1). Nga kjo kuptojmë që të ekzistoj kjo marrëdhënie pasurore e përbashkët martesore duhet të plotësohen dy kushte: ekzistenca së martesës dhe puna e bashkëshortëve gjatë ekzistencës së bashkësisë martesore (Podvorica, 2006).

Ekzistenca e martesës - është një ndër kushtet më të domosdoshëm për fitimin e pasurisë së përbashkët. Pa ekzistencën e kësaj bashkësie, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e pasurisë së përbashkët, për shkak se në këtë rast do të mungonte baza juridike mbi të cilën krijohet pasuria e përbashkët.

Puna e bashkëshortëve gjatë bashkësisë martesore - Liria e çdo bashkëshorti që të zhvillojë aftësitë e tij punuese, shpirtërore dhe aftësitë e tjera dhe veçanërisht të jetë i lirë në zgjedhjen e punës dhe profesionit paraqet një nga liritë themelore më të rëndësishme të njeriut (Selmani, 2020, fq. 142). Puna e bashkëshortëve gjatë martesës është kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët e cila mund të jetë individuale dhe e përbashkët (Podvorica, 2006, fq. 243). Puna është individuale atëherë kur bashkëshorti e kryen punën në mënyrë të lirë dhe realizon të ardhura që e rrisin vlerën e pasurisë së përbashkët, ndërsa është e përbashkët kur të dy bashkëshortët kanë të njëjtin profesion dhe punë (Podvorica, 2006). Karakteristikë e pasurisë së përbashkët është që bashkëshortët nuk mundën ta disponojnë pasurinë në mënyrë individuale, ata janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët vetëm nëse nuk janë marrë vesh ndryshe (Neni 48, LFK). Pra këtu qëndron fakti se të dy bashkëshortët janë titullarë të gjithë pasurisë në pjesët të papjesëtuara të sendeve dhe të drejtave e detyrimeve. Sipas neni 49 të LFK-së, bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht pronësinë dhe me marrëveshje. (Ligji për Familjen, 2006, neni 49). Kjo do të thotë se asnjëri nga bashkëshortët, nuk mund ta disponojë dhe ta shfrytëzojë në mënyrë të pavarur pjesën e pasurisë së përbashkët, deri sa ajo mos të pjesëtohet në mes të bashkëshortëve. Karakteristikë tjetër e veçantë e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, është se pasuria e tyre e përbashkët regjistrohet në regjistrin publik të pasurive të patundshme në emër të të dy bashkëshortëve (Ligji për Familjen, 2006, neni 50). Në regjistrin e të drejtave të pasurive të patundshme, regjistrimi konsiderohet se është bërë në emër të të dy bashkëshortëve, edhe kur bartës i të drejtës pronësore të pasurisë së përbashkët regjistrohet vetëm njëri prej bashkëshortëve (LFK, Neni 50). Sipas Ligjit mbi Barazinë Gjinore të Kosovës pasuri e përbashkët nënkupton pasurinë e krijuar gjatë martesës, e regjistruar në regjistrat publikë si pronë e përbashkët, në emër të dy partnerëve dhe se puna e të dy partnerëve përmes së cilës është krijuar pasuria e përbashkët, konsiderohet si kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët (Ligji Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore e Kosovës, neni 7).

Bashkëshortët në asnjë rrethanë nuk mund të përjashtohen nga pronësia e përbashkët (Aliu, 2014, fq.123). Mirëpo ajo në çdo kohë mund të ndryshojë në pronësi të veçantë përmes marrëveshjes në mes të bashkëshortëve apo vendimit të gjykatës. Me vendim të gjykatës

vendoset nëse nuk arrihet marrëveshja në mes të bashkëshortëve se cila pjesë i takon pasurisë së përbashkët, si të bëhet mirëmbajtja dhe administrimi i saj. (Ligji për Familjen, 2006, neni 54). Pasuria e përbashkët rregullohet më norma të natyrës urdhëruese, pra dispozitat juridike të cilat rregullojnë pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve janë detyruese dhe veprimet juridike të kryera në kundërshtim me këto dispozita, janë të pavlefshme.

3.2.3. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët pasurore

Neni 52 i Ligjit për Familjen sjellë parimin e njohur dhe të garantuar me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtare sipas së cilës asnjëri nga bashkëshortët nuk mundet në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Ky parim mbështetet në barabarësinë e bashkëshortëve dhe ndalon privimin arbitrar të tyre nga pasuria (Komentar, Ligji për Familjen e Kosovës, 2012, faqe 143). Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve garantohet edhe në rast e zgjidhjes së martesës, në rastet kur pasuria e përbashkët është krijuar në bashkësisë jashtëmartesore, sepse pronësia nuk mund t'i mohohet askujt, dhe as nuk mund të zhvishet nga pronësia përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj (Podvorica, 2006, fq.245). Sipas Ligjit për Familjen, të drejtën që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët janë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve (Neni 56, par.2, LFK). Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet me marrëveshjen e palëve, por edhe me vendim të gjykatës. Gjatë pjesëtimit të pasurisë gjykata do të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, ndihmën e ofruar njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët (Ligji për Familjen, 2006, neni 54).

Pasuria e përbashkët bashkëshortore mund të ndahet në dy mënyra:

- bashkëshortët mund të merren vesh për ndarjen e pasurisë së përbashkët (ndarja e pasurisë së përbashkët me marrëveshje ose vullnetare); dhe
- ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve do ta bëjë gjykata në procedurë gjyqësore (ndarja gjyqësore) (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 354).

3.2.4. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore me marrëveshje

Ligji për Familjen, respektivisht neni 53 rregullon formën me marrëveshje të pjesëtimit të pasurisë së përbashkët bashkëshortore e cila mund të bëhet në çdo moment gjatë jetës bashkëshortore apo edhe gjatë procesit të shkurorëzimit. Marrëveshja nënkupton pajtimin e tyre me shkrim që garanton pjesëtimin e pasurisë në mënyrë të qetë dhe kjo marrëveshje do të përcaktojë pjesët e tyre që u takojnë me rastin e ndarjes, të cilat do të konsiderohen si pronësi të veçanta. Ndarja e pasurisë së përbashkët bashkëshortore me marrëveshje është forma më e mirë e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Në rastet kur ekziston një vullnet i tillë në mes tyre lejohet çdo modalitet të cilin e lejon ligji. Një ndarje e tillë realizohet me Kontratë mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët, në formë të aktit noterial, ku bashkëshortët vendosin se si do të realizohet ndarja, çfarë do t'i takojë secilit nga bashkëshortët lidhur me sendet e paluajtshme dhe të luajtshme. Ndarja e pasurisë së bashkëshortëve me anë të aktit noteria, iu mundëson bashkëshortëve që pronësitë e tyre të veçanta t'i regjistrojnë në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri, ku secilit prej tyre i lëshohet certifikatë e veçantë për të drejtën e pronësisë apo të bashkëpronësisë mbi sendin. Kjo formë e pjesëtimit të pasurisë iu mundëson bashkëshortëve fleksibilitet më të lartë lidhur me disponimin e pasurisë së tyre. Me rastin e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve njëkohësisht vjen edhe deri tek shuaja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe lind pronësia e veçantë nëse ata janë ende në martesë për pjesën e pjesëtuar. Por nëse vazhdon martesja edhe më tej, sërisht themelohet pronësia e re e përbashkët për pjesën e krijuar pas momentit të pjesëtimit (Komentari për Ligjin për Familjen, 2012, 145). Sipas nenit 47 par. 4 të Ligjit për Familjen të Kosovës, pjesët e bashkëshortëve në pronësinë e përbashkët

konsiderohen si të barabarta nëse ndryshe nuk janë marrë vesh (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Në rast të mosrespektimit të këtij neni nga ana e bashkëshortëve, atëherë pjesëtimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore realizohet në rrugë gjyqësore, ku secili nga bashkëshortët kanë të drejtë të vërtetojnë pjesët e tyre në bazë të kontributit që kanë dhënë për fitimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve (Neni 89, LFK).

3.2.5. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nga ana e gjykatës

Pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Familjen, Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe ligjeve të tjera të cilat rregullojnë të drejtën mbi pronësinë. Pjesëtimi i pasurisë gjatë martesës i jep fund regjimit të bashkësisë duke i vendosur bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara. Bashkëshortët në shumë raste për ndarjen e pasurisë së përbashkët i drejtohen rrugës gjyqësore, për arsye se ata nuk mund të arrijnë marrëveshje për ndarje të pasurisë. Për këtë, bashkëshorti apo përfaqësuesi i tij ligjor i drejtohet gjykatës me një kërkesë-padi për ndarje të pasurisë. Kjo çështje do të zhvillohet para një gjykate kontestimore kompetente, ku do të shqyrtohen kundërshtimet e bashkëshortëve lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve. Qysh në fillim të procedurës së pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, bashkëshortët kanë të drejtë të veçojnë pasurinë e luajtshme vetjake, që ju përkiste para regjimit të bashkësisë si dhe atë që e kanë fituar gjatë bashkësisë martesore në formë trashëgimie, dhurimi, legu nëse ka qenë një rast i tillë (Mando, 2009, fq. 243). Pas veçimit të pasurisë së veçantë të bashkëshortëve, pasuria tjetër e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët (neni 76, LFK). Me qëllim që gjykata të vendosë drejt lidhur me përkatësinë e pasurisë së përbashkët (e veçantë apo e përbashkët) bashkëshortët duhet që përmes dokumenteve dhe provave tjera të paraqesin përkatësinë e pasurisë në gjendjen e saj fillestare. Pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet duke u nisur nga barazia e aktivitetit dhe pasivitetit të saj. Në fillim të procedurës për pjesëtim të pasurisë së përbashkët, gjykata ka për detyrë të caktojë masën e pasurisë së përbashkët e cila do të ndahet, pra duhet bërë vërtetimi i borxheve dhe kërkesave që rrjedhin nga pasuria e përbashkët ndaj personave të tretë (Podvorica, 2006, fq.246).

Caktimi i vlerës së pasurisë bëhet në bazë të gjendjes së pasurisë në momentin e mbarimit të martesës, mirëpo nëse martesa nuk ka mbaruar akoma (dhe pjesëtimi i pasurisë bëhet gjatë kohëzgjatjes së saj), atëherë kjo bëhet sipas gjendjes në kohën e ngritjes së padisë (Podvorica, 2006, fq.247). Borxhet që rezultojnë nga pasuria e përbashkët ndahen dhe llogariten në ndarje të pasurisë të secilit bashkëshort. Dispozita e nenit 91 të LFK-së gjen zbatim në rast se pasuria është e pandashme fizikisht ku thuhet se “në rast se pjesa e njërit bashkëshort në pasurinë e përbashkët është jo proporcionalisht më e vogël se pjesa e bashkëshortit tjetër, gjykata, me kërkesën e njërit nga bashkëshortët, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe vlerën e pasurisë së tij, atij bashkëshorti, mund t’ia caktojë shpërblimin në të holla sipas vlerës së pjesës së tij”. Kjo pasuri pjesëtohet në mënyrë të barabartë dhe secili prej bashkëshortëve merr pasurinë që i takon.

3.2.6. Vlerësimi i pasurisë së përbashkët dhe llogaritja e kontributit

Legjislacione të vendeve të ndryshme të botës, njohin sisteme të ndryshme të ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Legjislacioni i Kosovës, nisët nga fakti sipas së cilës bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët (Neni 47, par.4, LFK) . Ndërsa sipas nenit 53 par.1 të Ligjit për Familjen, ligdhënësi i ka udhëzuar nëse bashkëshortët nuk pajtohen me këtë lloj të ndarjes atëherë duhet të respektohet kontributi i tyre si fakt për fitimin e pronësisë së përbashkët (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Megjithatë, gjithmonë kërkohet që pretenduesi të argumentojë kontributin e tij në rritjen e masës së pasurisë në raport me kontributin e bashkëshortit tjetër.

Pas ndarjes së pasivit nga aktiva e pasurisë, fillon vlerësimi i përgjithshëm i pasurisë përbashkët, ku gjykata merr parasysh kontributin e secilit bashkëshort në fitimin dhe krijimin e asaj pasurie (Podvorica, 2006). Kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët mund të jetë në formë direkte apo indirekte. Kontributi direk në krijimin e masës pasurore është kur njëri bashkëshort në mënyrë të drejtpërdrejtë sjell të ardhura në të holla apo në natyrë. Kontributi indirekt është kur bashkëshorti nuk sjellë të ardhura drejtpërdrejt por në mënyrë indirekte kontribuon në rritjen e masës e përbashkët pasurore, si: kujdesin ndaj

fëmijëve, mirëmbajtjen dhe obligimet rreth shtëpisë, ndihmën dhe suportin e ofruar ndaj bashkëshortit tjetër etj. (Ligji për Familjen, 2006, neni 54). Rrethanat e cekura si më lart Gjykata duhet t'i vërtetojë në bazë të deklaratave dhe provave materiale të cilat i dorëzojnë bashkëshortët. Vendimi i gjykatës në këtë rast duhet të bazohet në të gjitha rrethanat, jo vetëm duke u bazuar në të ardhurat personale dhe të hyrat financiare të bashkëshortëve, por edhe ndihmën e njërit bashkëshort ofruar bashkëshortit tjetër të cilat janë të listuara në nenin 54 par.1 të Ligjit për Familjen, siç janë: kujdesi për fëmijë, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006).

Me rastin e pjesëtimit të pasurisë së bashkëshortëve, ku për bazë merret kontributi i bashkëshortëve, gjykata është para sfidës se si do të vlerësojë kontributin e njërit bashkëshort i cili gjatë bashkësisë martesore nuk ka qenë i punësuar dhe asnjëherë nuk ka sjellë të ardhura monetare në familje. Deri më tash, praktika gjyqësore në Kosovë, me rastin e ndarjes së pasurisë së bashkëshortëve është bazuar në vlerësimin e kontributeve në mënyrë monetare, ku amvisërisë i është caktuar një vlerë e një rroge minimale në shkallë kombëtare për vitin 2011 që është 130 euro për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare dhe 170 euro për të punësuarit deri mbi moshën 35 vjeçare. Vlerësim i tillë i punës së amvisërisë në kontributin e pasurisë së bashkëshortëve (zakonisht gratë janë ato që sakrifikojnë punën, karrierën për mirëqenien e familjes), paraqet shkelje të parimit themelor të së drejtës së barabartë të bashkëshortëve në ndarje të pasurisë së tyre.

Në ndryshimet e fundit të Ligjit nr.06/L-077 për Familjen datë 17.01.2019, neni 47 është plotësuar – riformuluar ashtu që në paragrafin e 3 thotë, citoj: **“Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm”** (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019, neni 47). Plotësimi i tillë do të shmangë në të ardhëm abuzimet lidhur me vlerësimin e kontributeve në krijimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, tani kontributi monetar i njërit bashkëshort do të konsiderohet i barasvlershëm me kontributin jo monetar të bashkëshortit tjetër. Ky

amandamentim shmangë abuzimin që ka të bëjë me ndarjen e pasurisë së përbashkët bashkëshortore.

Megjithatë, praktikat gjyqësore të krijuara ndër vite rreth interpretimit të nenit 54, kanë pamundësuar që plotësimi i nenit 47 rreth baras-vlefshmërisë së kontributeve të zbatohet gjatë sjelljes së vendimeve gjyqësore mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Konsiderohet se neni 47 i ndryshuar është në kolizion dhe kontradiktor me nenin 54 të LFK i cili kërkon vlerësimin e kontributeve në formë monetare. Lidhur me këtë çështje OJQ Inject iu është drejtuar edhe Gjykatës Supreme për të sqaruar paqartësitë rreth nenin 54 për mendim juridik.

Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme lidhur me vlerësimin e kontributeve, konsiderohet që çdo precizim sa më i detajuar i dispozitave ligjore do të shmangë abuzimet e mundshme në këtë drejtim.

Gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët gjykata vendos për nevojat dhe detyrat specifike të bashkëshortëve. Në rastet kur njërit bashkëshort i besohet fëmija në ruajtje dhe edukim, përveç pjesës që i takon sipas ligjit, ai do të disponojë edhe sendet që u shërbejnë vetëm fëmijëve në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

3.3. Kthimi i dhuratave në mes bashkëshortëve të shkurorëzuar

Shkëmbimi i dhuratave në mes të bashkëshortëve janë një ndër traditat të cilat janë përcjellë me shekuj. Ato simbolizojnë vlerë, dashuri, dhe respekt. Bashkëshortët në momentin e lidhjes së martesës, i shkëmbejnë dhuratat në mes vete. Këto dhurata konsiderohen me vlerë të lartë apo edhe të ulët (aksesorë nga ari, aksesorë me gurë të çmueshëm, këpucë, fustane, çejz etj.). Dhuratat sipas doktrinës juridike ndahen në dhurime të një vlere të madhe dhe në dhurime të rëndomta (Mulaj, 2011, fq. 77). Mirëpo në rast të shkurorëzimit dhe anulimit këto dhurata kthehen tek bashkëshortët të cilët i kanë dhuruar. Doktrina juridike në aspektin e dhuratave bazohet në dy elemente si: vlera dhe fajësia (Hamdi Podvorica, 2006, fq.137). Bashkëshorti i cili konsiderohet se nuk ka faj në shkurorëzim i mban të gjitha dhuratat që ka marrë nga bashkëshorti tjetër i cili është i fajshëm, për të cilit është bërë shkurorëzimi në bazë

të shkaqeve për shkurorëzim sipas LFK-së (Hamdi Podvorica, 2006, fq.137).. Sipas Nenit 13 të LFK-së, parashihet se dhuratat kthehen vetëm tek të fejuarit dhe nuk e rregullon çështjen për kthimin e dhuratave në mes të bashkëshortëve, mirëpo martesës i paraprinë fejesa. I fejuari apo fejuara mund të kërkojë që me anë të padisë për pasurime të pabazë të kërkojë kthimin e dhuratave. Ndërsa në Legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, çështja e kthimit të dhuratave ka koncept tjetër, në bazë të cilit parashihet se dhuratat e bëra në mes të bashkëshortëve para lidhjes martesore ose kohëzgjatjes së martesës, ato nuk kthehen (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, E drejta Familjare, 2020, fq. 357).

3.4. E drejta e banimit mes bashkëshortëve të shkurorëzuar

E drejta e banimit përkufizohet si servitut personal i cili mund të themelohet si një e drejtë që një person të shfrytëzojë një ndërtesë apo një pjesë të ndërtesës. (LPDTS, neni 265). Servituti personal është një e drejtë e një personi në favor të të cilit është ngarkuar një paluajtshmëri që ta përdorë në një mënyrë të caktuar ose të ndalojë ushtrimin e veprimit të caktuar apo të përjashtojë ushtrimin e një të drejte, e cila rrjedh nga pronësia në paluajtshmëri. (LPDTS, Neni 261). E drejta e banimit në aspektin bashkëshortor u takon të dy bashkëshortëve; nëse ajo është fituar në kohën e bashkëshortësisë, pa marrë parasysh se kujt i është ndarë banesa. Pra, titullar i të drejtës së banimit janë të dy bashkëshortët. Me vdekjen titullarëve, e drejta e banimit kalon te fëmijët e tyre, respektivisht te shfrytëzuesit e tjerë të banesës që kanë jetuar së bashku me bartësin e së drejtës së banimit kërkohet plotësimi i disa kushteve (Abdulla Aliu, E drejta Sendore, fq.138).

Në rast se bashkëshortët bëjnë zgjidhjen apo anulimin e martesës, një ndër pasojat juridike është edhe e drejta e banimit, pavarësisht se Ligji për Familjen i Kosovës këtë çështje e ka rregulluar në nenin 44, ku fillimisht në nenin 1 përparësi i jep bashkëshortët të vendosin për vendin e banimit me anë të marrëveshjes; pasi që çdo pasuri e krijuar gjatë martesës konsiderohet pasuri e përbashkët bashkëshortore (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, neni 44). Ka shumë raste kur bashkëshortët nuk arrijnë të dakordohen me këtë çështje. Për

zgjidhjen e kësaj çështje gjykata me aktgjykim lidhur me zgjidhjen e martesës, merr parasysh gjendjen ekonomike shëndetësore, kushtet e banimit të secilit bashkëshort, si dhe faktin se cilit prej bashkëshortëve i takojnë fëmijët e mitur të përbashkët. Në qoftë se banesa si pasuri e përbashkët martesore, nuk mund të ndahet fizikisht pasi që ajo humb funksionalitetin e saj, dhe nuk do të kishte plotësuar nevojat e asnjërit nga bashkëshortët tjetër, atëherë bashkëshortit të cilit i takon banesa ka për detyrë dhe obligim që bashkëshortit tjetër t’ia kompensojë një pjesë së banesës me të holla të cilën lartësinë e vlerës e cakton gjykata (Mulaj, 2011, fq. 80). Në praktikë e drejta e banimit i takon bashkëshortit që i besohen fëmijët në përkujdesje. Ligji nuk e bën ndarjen midis të drejtës së banimit në banesa shoqërore, ku ekziston vetëm e drejta e shfrytëzimit, gjykata me procedurë jo kontestimore do të vendosë se cilit bashkëshort do t’i takojë e drejta e banimit, çdo herë duke pasur parasysh, gjendjen pasurore të bashkëshortëve dhe përkujdesjen për fëmijë (Aliu & Gashi, 2007, fq. 179). Në praktikë, gjykata çdoherë vendosë që e drejta e banimit t’i takojë bashkëshortit që i besohen fëmijët për përkujdesje (Aliu & Gashi, 2007, fq. 179). Ndërsa, kur është fjala për pronën private, qoftë shtëpi apo banesë, gjykata do të vendosë me procedurë kontestimore dhe kjo çështje duhet të zgjidhet sipas rregullave të pjesëtimit të pasurisë së përbashkët (Aliu & Gashi, 2007, fq.179).

3.5. E drejta e trashëgimisë mes bashkëshortëve të shkurorëzuar

Martesa është bazë për trashëgim. Sipas Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, bashkëshorti ka të drejtë të trashëgojë bashkëshortin tjetër si trashëgimtar ligjor dhe të jetë pjesë e trashëgimisë me trashëgimtarët e tjerë në tri radhët të cilat janë paraparë në nga neni 12 i Ligjit për Trashëgimi të Kosovës (LTK). Bashkëshortët janë te barabartë sa i përket pozitës trashëgimore pavarësisht gjinisë. E drejta e trashëgimit në mes të bashkëshortëve nuk vazhdon kur bashkëshortët shkurorëzohen (Ligji për Trashëgimi i Kosovës, Neni 27. Parg.1). Ligji për Familjen ka paraparë shprehimisht rastet kur bashkëshortët humbin të drejtën e trashëgimisë ligjore në mes tyre. Martesa zgjidhet apo anulohet me vendim të gjykatës, bashkëshorti humbë të drejtën për trashëgim ligjor për shkak të martesës së mëparshme (Neni 98, LFK). Sipas

dispozitivit të paraparë në nenin 27 të Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, bashkëshorti me rastin e zgjidhjes së martesës apo anulimit të saj humbë të drejtën për të trashëguar nëse trashëgimlënësi ka paraqitur padi shkurorëzimi, kurse pas vdekjes së trashëgimlënësit është bërë shkurorëzimi me aktgjykim të formës së prerë (Neni 27, LFK). Në qoftë se martesa e tij me trashëgimlënësin anulohet me aktgjykim të formës së prerë pas vdekjes së trashëgimlënësit për shkaqet që bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës (Neni 27, par.2, LTK). Në qoftë se bashkëjetesa e tij me trashëgimlënësin ka pushuar me fajin e bashkëshortit pasjetues, ose në bazë të marrëveshjes me shkrim me trashëgimlënësin (Neni 27, par.2, LTK). Kur kemi të bëjmë me çështjen e trashëgimisë testamentare pas zgjidhjes apo anulimit të martesës na paraqiten dy situata, se a është përpiluar testamenti para apo pas zgjidhjes së martesës. Sipas situatës së parë, testamenti që është përpiluar përpara zgjidhjes apo anulimit të martesës, ai nuk mund të krijojë efekte juridike. Sipas situatës së dytë, nëse testamenti është përpiluar pas zgjidhjes apo anulimit të martesës, ai është i plotfuqishëm dhe krijon efekte juridike (Podvorica, 2005, fq.138).

3.6. Detyrimi i ushqyerjes së fëmijëve mes bashkëshortëve të shkurorëzuar

E drejta prindërore si e drejtë subjektive e prindërve, do të thotë si tërësi e të drejtave dhe detyrave që i ushtrojnë ata ndaj fëmijëve (Selmani & Rexhepi, 2014, fq.255). Në momentin që një person bëhet prind atëherë lindin përgjegjësi dhe detyrime morale dhe ligjore. Objekt i këtyre përgjegjësisë të cilat lindin nga prindërit në raport me fëmijët përfshijnë të drejta dhe detyrime që kanë për qëllim sigurimin dhe garantimin e një mirëqenieje morale (emocionale, shoqërore) dhe materiale për fëmijën (Selmani & Rexhepi, 2014, fq.256). Këto detyrime dhe përgjegjësi parashihen edhe në nenin 128 të LFK-së: *Përgjegjësia prindërore rezulton fillimisht nga e drejta për kujdes prindëror; Fëmija është nën përgjegjësi prindërore deri në moshën madhore; Prindërit janë të detyruar të sigurojnë në çdo kohë që parimet e përcaktuara në nenin 125 të këtij Ligji përdoren për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të mitur; Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i*

siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë. Duke i zbatuar këto parime, prindërit duhet t'i kenë në konsideratë aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006, nen 125) .

Një nga detyrat dhe përgjegjësitë është edhe detyrimi për ushqim. Përmbushja e këtij detyrimi nënkupton përmbushjen në mënyrë të rregullt të nevojave për ushqim, banim, përmbushjen në mënyrë të rregullt të nevojave për fëmijët e mitur dhe të nevojave për arsim, edukim dhe nevojave kulturore (Podvorica, 2005, fq.221). Sipas detyrës zyrtare ex officio, gjykata kujdeset për caktimin e të drejtës së ushqimit të fëmijëve të mitur të përbashkët. Kjo e drejtë pushon kur fëmijët mbushin moshën madhore dhe fitojnë zotësinë e veprimit, nëse kanë mbushur 15 vjet dhe kanë hyrë në punë si dhe nëse e vazhdojnë arsimimin e lartë pas mbushjes së moshës 26 vjeçare (Mulaj, 2011, fq. 79). Parimet për përcaktimin e mbajtjes dhe alimentacionit janë paraparë në nenin 330 të Ligjit për Familjen. Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante. Kur alimentacioni kërkohet për fëmijën, gjykata merr parasysh moshën e fëmijës dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimimin (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006).

Në mënyrë specifike me dispozitat ligjore në fuqi është përcaktuar se prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre. Dhënia e ushqimit zakonisht bëhet në para. Duke u bazuar në dispozitat e Nenit 278 të LFK-së, ushqimi mund të jepet në dy mënyra: në para ose në natyrë. Në procedurën për zgjidhjen apo anulimin e martesës, me vendim të marrë nga gjykata vendoset edhe çështja lidhur me ushqimin e fëmijëve të mitur. Bashkëshorti, të cilit nuk iu është vendosur mbajtja dhe kujdesi i fëmijëve, detyrohet të kontribuojë në ushqimin e fëmijëve. Në rastet kur alimentacioni kërkohet për fëmijët, gjykata merr parasysh rrethanat për nevojë të shpenzimeve elementare, edukimit dhe arsimimit si dhe moshën e fëmijës.

KAPITULLI I KATËRT

4. PASOJAT JURIDIKE PERSONALE TË SHKURORËZIMIT

Me pushimin e martesës lindin edhe pasoja juridike të cilat ndikojnë në raportet bashkëshortore dhe fëmijëve. Pasoja juridike më e rëndësishme nga pushimi i martesës është humbja e statusit martesor, nga e cila më tutje burojnë edhe pasoja të tjera, këto pasoja mund të jenë pasoja të natyrës juridike, personale dhe pasoja të natyrës pasurore (Zendeli et al., 2020, fq.183).

Pasojat juridike personale janë:

- pasojat juridike për bashkëshortët;
- pasojat juridike për fëmijët (Podvorica, 2005, fq.135).

4.1. Pasojat juridike të karakterit personal mes bashkëshortëve

Bashkëshortët mbajnë në vete pasojat juridike të cilat rezultojnë si shkas i pushimit të martesës. Mbiemri është pasojë juridike me karakter personal që rezulton si pasojë e shkurorëzimit në mes të bashkëshortëve. Bashkëshortët në rast të lidhjes së martesës pajtohen të shtojnë njërin nga mbiemrat e bashkëshortëve apo ta mbajnë atë që kanë pasur para lidhjes. Kjo është e paraparë edhe në Ligjin për Familje të Kosovës të parg.1 neni 96, i cili parasheh se bashkëshorti i cili ka në rastin e martesës e ka ndryshuar mbiemrin, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006). Procesi për kthimin e mbiemrit bëhet përmes deklaratës e cila jepet para nëpunësit të gjendjes civile (ofiçarit) në afat brenda 6 muajsh nga zgjidhja e martesës. Mbiemri i fëmijës me marrëveshjen e prindërve është e rregulluar me nenin 130 të Ligjit për Familje të Kosovës. Në qoftë se prindërit nuk arrijnë të dakordohen lidhur me caktimin e mbiemrit të fëmijës, mbiemri përcaktohet nga Organi i Kujdestarisë, pasi t'i dëgjojë të dy prindërit. Për dallim nga LFK, Kodi i Familjes i Shqipërisë parasheh se në qoftë se prindërit nuk arrijnë marrëveshje në caktimin e mbiemrit të fëmijës atëherë fëmija merr mbiemrin e të atit. (Kodi i Familjes, neni 52, Shqipëri). Sa i përket mbiemrit të fëmijës pas zgjidhjes së martesës ajo rregullohet me ligj të veçantë (Ligji për emrin Personal i Kosovës, nr. 02/L-118).

4.2. E drejta e lidhjes së serishme të martesës

Rimartesa është një akt civil (Beqja & Sokoli, 2000, fq.175). Edhe bashkëshortët e shkurorëzuar, pas shuarjes së martesës së tyre arrijnë të shohin gabimet dhe të metat të cilat kanë qenë të pranishme gjatë martesës së tyre. Që martesa e re të mos jetë nule duhet që martesa e mëparshme të shuhet, kjo parashihet në nenin 62 të Ligjit të Familjes së Kosovës. Rimartesa mund të konsiderohet një ndër pasojat kryesore për shuarjen martesës. (Selmani & Rexhepi, 2014).

4.3. Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët e përbashkët

Fëmijët gjithmonë janë viktimë në çështjen e zgjidhjes së martesës pasi ata gjinden në një situatë ku më nuk kanë mundësi të realizojnë jetën e tyre të përbashkët me të dy prindërit. Një nga pasojat më të vështira të shkurorëzimit është çështja e realizimit të të drejtave prindërore pas shkurorëzimit apo anulimit të martesës, pasi që bashkëshortët më nuk jetojnë bashkë dhe si pasojë e saj është mosrealizimi i tërësishëm i të drejtave prindërore ndaj fëmijëve. Të gjitha këto pasoja rezultojnë si shkas i zgjidhjes apo anulimit të martesës të cilat ndikojnë në të ardhmen e fëmijëve.

Gjykata sipas detyrës zyrtare, vendosë në dispozitivin e aktgjykimit për zgjidhje apo anulim të martesës, se cilit prind i besohet fëmija për ruajtje dhe mbajtje, dhe kontaktet personale të fëmijës me prindin të cilit nuk iu është besuar ruajtja dhe mbajtja e tij, për çështjen lidhur me ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijës, prindërit dakordohen me marrëveshje (Podvorica, 2006). Qëllimi kryesor i Gjykatës në rast të zgjidhjes apo anulimit të martesës, është interesi më i mirë dhe më i favorshëm i fëmijëve. Kjo është e paraparë edhe në Kodin e Familjes së Shqipërisë prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet e tyre, duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës (Kodi i Familjes së Shqipërisë, neni 2).

Aktgjykimi i gjykatës duhet të përmbajë njërin nga këto tri vendime:

- a) Të gjithë fëmijët mund t'i besohen në ruajtje dhe mbrojtje njërit prind;
- b) Që fëmijët të ndahen, ashtu që një apo më shumë prej tyre t'i besohen nënës dhe një apo më shumë babait; dhe

c) Që t'i besohen në personi të tretë apo ndonjë institucioni tjetër (Podvorica, 2006).

4.4. Kujdestaria e fëmijëve me rastin e shkurorëzimit

Është detyrë dhe e drejtë e prindërve që të kujdesen për mirëritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimin e fëmijëve (Mandro, 2009, fq.491). Gjatë procedurës së anulimit apo zgjidhjes së martesës, kur janë të pranishëm edhe fëmijët në atë procedurë, sipas nenit 140 të Ligjit për Familjen të Kosovës përcakton se gjykata merr vendim përveç zgjidhjes së martesës edhe shqyrtimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore. Në shumë raste kur prindërit nuk arrijnë të dakordohen lidhur me besimin e fëmijëve, atëherë Gjykata ka për detyrë të vendosë lidhur me këtë çështje se cilit nga prindërit duhet besuar fëmijët. Gjykata këtë veprim e ndërmerr në bashkëpunim me mendimin dhe propozimin e dhënë nga Organi i Kujdestarisë. Bashkëshorti të cilit iu është dhënë përkujdesa e fëmijëve me aktgjykim nga gjykata nuk ka të drejtë të pengojë kontaktet personale të fëmijës me bashkëshortin tjetër (Neni 140.3, LFK). Në rast të pengesave të shkaktuara, gjykata me kërkesën e njërit prind apo të Organit të Kujdestarisë, ndryshon vendimin mbi kujdestarinë. Neni 290 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen, parasheh se prindërit kanë detyrim ligjor të sigurojnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe për aftësimin e tyre për punë të pavarur derisa të mbushin moshën madhore, ndërsa në kushte të përcaktuara ligjore edhe pas moshës madhore (deri në moshën 26 vjeç nëse vazhdojnë shkollimin). Gjykata nuk e përjashton mundësinë që kujdestaria e fëmijëve t'i jepet edhe personave të tretë. Ky opsion vihet në realizim kur kemi të bëjmë me mirëqenien e fëmijës. LFK-ja e rregullon këtë më dispozitat e nenit 142.

4.4.1. Roli i organit të kujdestarisë në procedurën e dhënies së kujdestarisë për fëmijë

Organi i Kujdestarisë - është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-081 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 7).

Edhe në të drejtën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Organi i Kujdestarisë, i cili ka kompetencë lëndore për punët rreth kujdestarisë është Qendra për Punë Sociale (Zendeli, Selmani, 2020, fq. 303). Organi i kujdestarisë karakterizohet si një institut shoqëror me anë të të cilit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë sigurohet mbrojtja e personalitetit, të pasurisë dhe interesave pasurore të personave, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten (Zendeli, Selmani, 2020, fq.304).

Roli i organit të kujdestarisë në procedurën e kujdestarisë për fëmijë ka këto të drejta dhe detyrime: ushtron mbikëqyrjen e përgjithshme dhe të vazhdueshme mbi ushtrimin e të drejtave dhe të detyrimeve të prindërve (neni 147 i LFK-së); ka të drejtë të paraqesë padi për kundërshtimin e amësisë në emër të fëmijëve të mitur (neni 120, paragrafi 2, LFK); ndërmerr masa parandaluese për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave, dhe interesave të fëmijëve të mitur; angazhohet në procedurën për realizimin e detyrimit ligjor të ushqimit; jep mendim dhe propozim lidhur me çështjen e besimit të fëmijëve (neni 144, paragrafi 2 i LFK-së); merr pjesë në procedurën gjyqësore kur vendoset për besimin dhe kontaktet lidhur me fëmijë; përcakton mbiemrin e fëmijës kur prindërit nuk arrijnë marrëveshje (neni 130, par.4 i LFK-së). Gjatë procedurës gjyqësore lidhur me zgjidhjen martesës dhe besimin e kujdestarisë ndaj fëmijëve, Organi i Kujdestarisë ka pjesëmarrje të obliguar në procedurë (Neni 6 i LFK-së) i cili ka një rol të rëndësishëm për ndihmën ashtu edhe për këshillimin e gjykatës dhe propozimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe interesin e tyre më të favorshëm në procedurat lidhur me zgjidhjen e martesës dhe besimin e kujdestarisë së tyre (Neni 6, LFK)

Sipas nenit 144, paragrafi 1 të LFK-së, Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili merr vendim mbi dhënien e kujdestarisë së fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që t'i hetojë në mënyrë të përshtatshme mundësit, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të fëmijës (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006).

4.4.2. Kontaktet personale të prindërve të shkurorëzuar me fëmijët e tyre

Sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 (OKB, 1989) , neni 9, paragrafi 3, përcakton:

“ Shtetet palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës” (Neni 9, OKB).

Gjykata në procedurën gjyqësore lidhur me zgjidhjen e martesës vendos edhe çështjen lidhur me dhënien e fëmijëve në ruajtje, kujdes dhe edukim. Prindi të cilit nuk i besohet kujdestaria e fëmijës, ka të drejtën e kontakteve personale më fëmijët. Mirëpo këtë çështje prindërit mund ta rregullojnë edhe me marrëveshje. Kur nuk arrihet kjo marrëveshje, gjykata vendos me aktgjykim dhe specifikon mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin të cilit nuk iu është besuar kujdestaria (Neni 140, LFK). Kjo çështje është e rregulluar edhe në nenin 145 të Ligjit të Familjes së Kosovës.

Mirëpo edhe në qoftë se arrihet marrëveshja në mes të prindërve, por nuk është në interes të fëmijëve atëherë vjen në shprehje vendimi i gjykatës. Prindërit kanë të drejta dhe obligime ndaj fëmijëve dhe këto të drejta nuk humben as në rast të zgjidhjes së martesës. Mbajtja e raporteve personale apo kontakti me fëmijët është detyrim ligjor i prindërve (Neni 140, LFK). Ligji i Familjes së Kosovës, ka rregulluar edhe rastet kur prindi, i cili ushtron kujdesin prindëror, pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prind, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës (Neni 140, par.3 dhe 4, LFK). Gjykata, me kërkesën e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara (Neni 140, par.3 dhe 4, LFK).

4.4.3. Kujdestaria e përbashkët pas shkurorëzimit - Joint Custody

E drejta prindërore mund të paraqitet në dy forma themelore, edhe atë:

- 1) Ushtrimi i së drejtës prindërore nga të dy prindërit;
- 2) Ushtrimi i së drejtës prindërore vetëm nga ana e njërit prej prindërve (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 235).

Shumë shtete evropiane për përgjegjësi prindërore pas shkurorëzimit bazohen në Konceptin Joint Custody apo Kujdestaria e përbashkët ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit. Ky koncept pasqyron Deklaratën të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, miratuar më 20 nëntor 1989 (OKB, 1989). Kujdestaria e përbashkët nënkupton kur të dy prindërit pas ndarjes bashkëshortore marrin përgjegjësi të barabarta ndaj fëmijëve. Ushtrimi i së drejtës prindërore në rastet gjyqësore dhe praktike shpesh herë realizohet vetëm nga nëna. Mirëpo me ndryshimet në legjislacionin bashkëkohor, qëllimi i tyre prekë aspektin e interesit më të mirë ndaj fëmijës duke cilësuar se kujdesi dhe edukimi i fëmijës mundësohet me anë të realizimit nga të dy prindërit pavarësisht situatës dhe gjendjes martesore të bashkëshortëve; se a janë të martuar, a jetojnë në bashkësi jashtëmartesore apo janë të shkurorëzuar (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 235). Prindërit me kujdestari të përbashkët ndajnë përgjegjësinë dhe autoritetin ligjor për të marrë vendime të rëndësishme që ndikojnë tek ata fëmijët për çështje të tilla si edukimi, kujdesi mjekësor, praktika fetare dhe vendime të tjera thelbësore prindërore (Scott, E., & Derdeyn, A., 1984). Për dallim nga kujdestaria e vetme ku një prind i takon drejta për të vendosur për të ardhmen e fëmijës, me kujdestarinë e përbashkët të dy prindërit janë të përfshirë në mënyrë aktive në këto vendime. Zbatimi i këtij koncepti ka filluar të jetë pjesë e legjislacionit evropian në shtetet si: Italia e cila gjen zbatim që nga viti 2006 dhe përmban vetëm 5 nene (Murru, S, 2021), Austria, Franca, Gjermania, Britania e Madhe, Belgjika etj. Sipas Kodit Civil Gjerman, neni 1671 parasheh se kujdestaria e përbashkët ndaj fëmijëve realizohet kur asnjëri nga prindërit nuk kërkojnë të kenë kujdestari të vetme ndaj fëmijës. Gjithashtu Franca në legjislacionin e tij parim kryesor ka ushtrimin e përbashkët të përgjegjësisë prindërore nga ana e të dy prindërve (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 236). Për dallim nga kodet civile të shteteve evropiane që mbështesin këtë koncept, shteti i Kosovës nuk e parasheh në legjislacionin juridik ende kujdestarinë e përbashkët pas shkurorëzimit të martesës.

Interesimi dhe zbatimi i lartë i këtij koncepti nga shtetet evropiane, kanë sjellë vlerësime pozitive. Një nga qëllimet kryesore të realizimit të këtij koncepti është ushtrimi i përbashkët i së drejtës prindërore e cila mundëson përfshirjen dhe praninë më të madhe të babait në jetën e

fëmijës, si dhe realizimin e përgjegjësisë prindërore në raport me fëmijët (Zendeli, Selmani, Mickovic, Ristov, 2020, fq. 246).

4.5. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Shkurorëzimi si një fenomen social, është rritur shumë në kohën të cilën jetojmë. Ky fenomen po krijon pasoja juridike dhe emocionale, ku në të shumtën e rasteve çiftet e shkurorëzuara kanë fëmijë, për të cilët shkurorëzimi luan rol në rahatimin emocional, zhvillimin edhe mirëqenien e tyre ku të gjitha po ndikojnë në ndërtimin e personalitetit dhe rritjen e tyre si individ. Shkurorëzimi është përfundimi i një martesë të vlefshme në mes të bashkëshortëve. Arsyeet pse vijnë deri tek përfundimi i kësaj martese janë të shumta, por qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e stabilitetit psikik dhe fizik të fëmijës.

Gjykata dhe Organi i Kujdestarisë, gjatë procedurës së zgjidhjes dhe anulimit të martesës, ku u jep përparësi mbrojtjes së interesave të fëmijëve. Ligji për Familjen i Kosovës ka paraparë rolin e gjykatës që gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore në kontestet martesore, gjykatat duhet t'i përmbahen dhe t'i zbatojnë parimet për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të përcaktuara në nenin 125. Ligji për Familjen, ka paraparë masë mbrojtëse për nënën e fëmijës dhe fëmijën duke marrë parasysh rrethanat e vështira shëndetësore nga shtatzënia që paraqiten tek nënat: *“Bashkëshortët nuk duhet të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të mbushë një vit (Neni 71, LFK).”* Gjykata gjatë shqyrtimit të procedurës së shkurorëzimit, ofron mbrojtje juridike për të drejtat e fëmijëve që ex officio të caktojë masa të përkohshme duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Familjen të Kosovës.

4.6. Praktika gjyqësore lidhur me shkurorëzimet dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët të fituar gjatë bashkësisë martesore

Përveç aspekteve juridike teorike, gjatë punimit të kësaj teme janë marrë dhe analizuar katër raste nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke paraqitur disa nga veçoritë personale të paditësve siç janë: rastet e inicimit të procedurës nga burri apo gruaja, me padi dhe marrëveshje pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe kthimi i dhuratave mes bashkëshortëve të shkurorëzuar.

Rasti 1: Zgjidhja e martesës

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.5145/21 i datës 28.10.2021

Paditësi V.K nga ...,Rr "...", p.nr. ka paraqitur padi për zgjidhje të martesës kundër të paditurës A.K nga ...,Rr"...", duke theksuar se palët kanë lidhur martesë me datë 06.01.2020 dhe pas një kohe duke qenë se raportet martesore janë keqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, për shkak të karaktereve dhe botëkuptimeve të ndryshme për jetën e përbashkët, bashkësia faktike martesore është shkëputur dhe nuk ka pasur gjasa që e njëjta të rivendoset. E paditura, ka parashtruar përgjigje në padi me dt. 04.10.2021, me të cilën nuk e ka kontestuar padinë për zgjidhjen e martesës, duke i propozuar Gjykatës që ta zgjidhë martesën e lidhur me datë 06.01.2020, me shkurorëzim. Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit Av. L.S , ka deklaruar se pasi që palët faktikisht jetojnë të ndarë dhe kanë shkëputur bashkësinë faktike martesore, nuk kanë komunikim mes vete, ku ekziston interesi juridik i dyanshëm për zgjidhjen e martesës, ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e martesës. Prandaj i ka propozuar Gjykatës që martesa të zgjidhet me aktgjykim. **Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, , C.nr.5145/21 i datës 28.10.2021 – I.** ZGJIDHET me shkurorëzim martesa e lidhur në mes të paditësit V.K, nga ..., i lindur me dt. 17.12.1994, dhe të paditurës A.K, nga .., e lindur me dt. 15.10.1999, e lidhur me datën 06.01.2020, pranë Zyrës së Gjendjes Civile në ..., e regjistruar me nr. rendor 12, me numër te referencës II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata ka vlerësuar se kushtet për zgjidhje të martesës janë plotësuar nga neni 68 dhe 69. Gjykata, ka gjetur zbatim të dispozitave të nenit 68 par. 1 të LFK-së ku është e paraparë se “martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se “bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme.

Rasti 2: Zgjidhja e martesës me marrëveshje

Përshkrimi i rastit Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.3232/19 i datës 20.12.2019

Propozuesi B.B., nga F.K., me vendbanim në Gj. dhe propozuesi B.S., nga fshati B., Komuna e Obiliqit kanë bërë propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës së lidhur me datë 14.09.2015. Pas lidhjes së martesës për një kohë kanë jetuar të lumtur dhe në harmoni të plotë. Më vonë raportet mes tyre kanë ndryshuar dhe për shkak të zënkave të përditshme, jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Si pasojë e kësaj para një viti e tre muaj ka ardhur edhe deri te ndarja faktike e tyre. Nga kjo martesë propozuesit nuk kanë fëmijë.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3232/19 i datës 20.12.2019

I. Shkurorëzohet me marrëveshje martesa e lidhur me datën 14.09.2015, në Zyrën e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë, nën numrin rendor 17, dhe numër të referencës 9/2015RM/900., në mes të propozuesit B.B. data e lindjes..., në P., nga babai I. dhe nëna E. dhe propozueses B.B., e vajzërisë S., data e lindjes..., në B., nga babai H. dhe nëna L.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata për marrjen e këtij Aktgjykimi u bazua pas administrimit të provës dhe vlerësimit të deklaratave të autorizuarve të propozuesve gjeti se janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e martesës nga neni 69 paragrafi 1 dhe 2 i LFK-së. Prandaj, në përputhje me nenin 68 paragrafit 2 të LFK- së e aprovoi propozimin e tyre të përbashkët për shkurorëzim të martesës.

Neni 68 paragrafi 2 i Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës (tani e tutje: LFK) parasheh se *“Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente.”*

Me nenin 69 paragrafi 1 të LFK-së parashihet se: *“Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme.”* Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 347 të Ligjit për Familjen të Kosovës lidhur me nenin 450 të LPK-së.

Rasti 3: Ndarje të pasurisë së përbashkët të fituar në bashkësinë martesore

Përshkrimi i rastit Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.2119/10 i datës 16.02.2021

Paditësja L.I, adresa: rr. “T”. përmes të autorizuarit të saj më datë 30.09.2010 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit R.I., adresa: lagja Prishtinë, me objekt të kontestit ndarje e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Në padi ka paraqitur se ndërgjyqësit kanë qenë në martesë prej dt.29.12.2000 e deri në vitin 2006 kur është ndërprerë jetesa e përbashkët dhe është zgjidhur martesa me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më dt.18.12.2009 më tej ka shtuar se me rastin e martesës paditësja tek i padituri ka dërguar edhe disa dhurata sipas traditave të vendit, duke përfshirë stoli ari, të llojeve të ndryshme, vlerë e cila arrinte një shumë të konsiderueshme. Gjithashtu ajo kishte sjellë edhe çejzin të cilin e kishte përgatitur më herët si vajzë i cili përbëhej nga gjësende që i përgatisnin vajzat; ka sjellë fustane, komplete të teshave, etj. Lidhur me krijimin e pasurisë së përbashkët gjatë jetesës martesore, sipas përfaqësuesit të paditëses ata kanë krijuar masë pasurore e cila përfshinte sende të luajtshme duke përfshirë materiale për kuzhinë, orendi shtëpiake të llojeve të ndryshme si dhe veshmbathje. I njëjti ka paraqitur se gjatë vitit 2003 me kontribut të bashkëshortëve është ndërtuar lokali hotelier (Vila Lira në Gërmi) e cila evidentohet në emër të të paditurit, kurse në vitin 2006 pas ndarjes i padituri formalisht këtë lokal e kishte bartur në

emër të motrës së vet. Paditësja ka kërkuar që t'i njihet e drejta e pronësisë në pasurinë e përbashkët mbi bazën e kontributit të njëjtë të bashkëshortëve me nga ½ e pjesës.

Aktgjykimi i Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.2119/10 i datës 16.02.2021

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses L. I. nga Prishtina, DETYROHET i padituri R. I. nga Prishtina, që paditëses në emër të kontributit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore të krijuar nga “Vila Lira” në Gërmi me nr. të biznesit 80709242 për periudhën 2003-2006 të i paguaj shumën prej 12,740.15€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

II. DETYROHET i padituri R. I. nga Prishtina, që paditëses t’ia paguajë kamatën për pjesën e aprovuar të padisë, në lartësi të cilën e paguajnë bankat në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 10.02.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,129€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses L. I. mbi shumat e aprovuara, ashtu që të detyrohet i padituri që paditëses në emër të kontributit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore dhe atë për pasurinë personale 18,100.00€; për pasurinë e përbashkët për vlerën ndërtimore të Vila “Lira” në Gërmi shumën prej 8,263.00€; për fitimin e përbashkët nga hoteleria me Vila “Lira” për kohën 2003-2006 shumën 34,499.85€; për orendi, pajisje shtëpiake 1.277.00€.

Gjykata për marrjen e këtij Aktgjykimi ka zbatuar Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/32, në nenin 47 par. 1 dhe 4 i cili parasheh:

“Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh.”

Ka zbatuar Ligjin për Familjen të Kosovës, neni 52 dhe nenin 54 parg.1, 2, ku sipas nenit 52 të LFK-së: “Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij.”

Në nenin 54 përcakton: Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni. Dispozitat ligjore të cekura kornizojnë mënyrën e pjesëtimit të pasurisë dhe pjesët takuese. Rrjedhimisht përcaktimi në nenin 47.4 i dhënë në formë të fiksionit juridik, zbërthehet përmes nenit 54 i cili orienton barrën e të provuarit tek bashkëshorti i cili pretendon se ka kontribut me të theksuar në krijimin e pasurisë bashkëshortore.

Lidhur me pjesën e kërkesëpadisë që kishte të bënte me kompensimin për orendi, Gjykata e refuzoi pasi konkludoi se nuk është arritur të argumentohet, dhe nuk ka pasur prova të mjaftueshme për tu besuar se mund të realizohet kërkesëpadia nga ana e paditëses. Gjykata për çështjen e kërkesës së kamatës nga ana e paditëses vendosi në bazë të nenit 277 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD), ku e detyroi të paditurin që paditëses në shumat e gjykuara t'ia paguajë edhe kamatën e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë.

Rasti 4: Kthimi i dhuratave mes bashkëshortëve të shkurorëzuar

Përshkrimi i rastit Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2679/18 i datës 29.07.2021

Paditësi me të paditurën janë fejuar në muajin gusht 2017 dhe se me rastin e fejesës paditëses i ka dhuruar ari në vlerë prej 5.000, € dhe ka deponuar shumën në vlerë prej 8.865,00 €, në llogari të saj në Bankën Raiffeisen, në emër të dhuratës së fejesës. Ka shtuar se fejesa nuk ka përfunduar me martesë, por me ndarje pa marrëveshje dhe se më të paditurën kanë bashkëjetuar si të fejuar deri me datë 10.07.2018, kur e paditura e ka marrë arin dhe ka ikur pa

sqarim dhe ky moment konsiderohet si prishje e fejesës. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi dhe e paditura pasi janë njoftuar janë fejuar dhe me pas janë martuar, ka shtuar se e paditura pa dijeninë e paditësit i ka marrë shumën e të hollave të cekura në padi, i ka deponuar në bankë në emër të saj, ka theksuar se e paditura kur është larguar nga i padituri e ka marrë me vete arin të cilin ia ka dhuruar për fejesë.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2679/18 i datës 29.07.2021

I. REFUZOHET, kërkesëpadia e paditësit E. E. nga Prishtina, më të cilën ka kërkuar që të DETYROHET, e paditura K. B. nga Kamenica, që të ia kthejë shumën monetare në vlerë prej 8.865 € (tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro), si dhe arin më vlerë prej 5.000 € (pesë mijë euro), të marra në emër të dhuratës së fejesës, nga paditësi me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor, SI E PA BAZUAR.

OBLIGOHET paditësi, që në emër të shpenzimeve procedurale, të paditurës t’ia paguajë shumën prej 478.00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata për marrjen e këtij Aktgjykimi ka marrë parasysh të gjitha provat dhe ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Gjykata konstaton se edhe po të ishte provuar se e paditura i ka marrë si dhuratë paratë dhe arin nga paditësi, nuk plotësohen kushtet që këto dhurata të kërkohen nga ana e paditësit ngase sipas nenit 13 të Ligjit të Familjes të Kosovës, te kthimi i dhuratave thuhet se “nëse fejesa nuk përfundon më martesë, secili i fejuar mund të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave të cilat i ka dhënë me rastin e fejesës” e në rastin konkret gjykata e ka vërtetuar faktin se palët ndërgjygjëse kanë lidhur martesë dhe në momentin e lidhjes së martesës të drejtat e parapara më ligj lidhur me fejesën nuk paraqesin ndonjë efekt juridik ngase me lidhje të martesës pushojnë edhe këto të drejta.



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Aurela Beka (Kandidate për Magjistraturë)

Fakulteti Drejtësisë – Universiteti i Evropës Juglindore

Mentor: Doc.dr. Arta Selmani-Bakui

Anketë profesionale për përgatitjen e punimit të Magjistraturës me temë:

“ Pasojat juridike të shkurorëzimit në Republikën e Kosovës gjatë periudhës 2012-2016”.

Në target grupin e përfshirë për realizimin e kësaj ankete janë: gjyqtarë, avokatë, noterë dhe qytetarë të regjionit të Prishtinës. Në këtë anketim kanë marrë pjesë 100 persona, prej tyre 15 gjyqtarë, 30 avokatë, 10 noterë, dhe 55 qytetarë.

Anketa ka gjithsej 5 pyetje me 3 përgjigje alternative për secilën pyetje: **pajtohem, nuk pajtohem dhe nuk e di**.

Rezultat i anketës do të jenë statistika dhe të pasqyruara me anë të grafikonave. Anketa është anonime dhe do të përdoret vetëm për qëllimin e punimit/kërkimit shkencor.

Datë: 15.03.2022

A N K E T Ë

1. A mendoni se Kodi Civil i Republikës së Kosovës duhet të përmbajë dispozita lidhur me kontratën martesore?

- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem
- c) nuk e di

2. A mendoni se kontrata martesore është zgjidhje për rregullimin e raporteve juridiko pasurore në mes bashkëshortëve?

- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem
- c) nuk e di

3. A mendoni se kontrata martesore lehtëson procedurën gjyqësore lidhur me ndarjes e pasurisë gjatë shkurorëzimit?

- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem
- c) nuk e di

4. A mendoni se me kontratë martesore ekziston rreziku i cenimit të parimit të barazisë së bashkëshortëve lidhur me pronën e krijuar gjatë martesës?


- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem
- c) nuk e di

5. A ekziston rreziku që kontrata martesore të përdoret si mjet abuzimi nga ana e njërit bashkëshort?


- a) pajtohem
- b) nuk pajtohem
- c) nuk e di

Ju faleminderit për kohën tuaj dhe plotësimin e kësaj ankete!


REZULTATET E ANKESTËS




2. A mendoni se kontrata martesore është zgjidhje për rregullimin e raporteve juridiko-pasurore në mes bashkëshortëve ?




3. A mendoni se kontrata martesore e lehtëson procedurën gjyqësore lidhur me ndarjen e pasurisë gjatë shkurorizimit ?



4. A mendoni se me kontratë martesore ekziston rreziku i cenimit të parimit të barazisë së bashkëshortëve lidhur me pronën e krijuar gjatë martesës ?



5. A ekziston rreziku që kontrata martesore, të përdoret si mjet abuzimi nga ana e njërit bashkëshortë ?



PËRFUNDIME

Martesa është një ndër institutet më të vjetra të njerëzimit dhe familjes e cila ka kaluar në etapa të ndryshme të zhvillimit. Në Republikën e Kosovës marrëdhëniet martesore janë të rregulluara me hyrjen në fuqi të Ligjit për Familjen Nr.2004/32 datë 01.09.2006 ndërsa së shpejti pritet hyrja në fuqi e Kodit Civil të Kosovës i cili në mënyrë të detajuar në librin e katërt ka të rregulluar marrëdhëniet martesore si dhe marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në martesë.

E drejta martesore si pjesë përbërëse e shkencës juridike mbi të drejtën familjare përfshinë tërësinë e studimeve, që i referohet rregullimit juridik të martesës dhe marrëdhënieve martesore. Normat juridike të cilat i përfshinë e drejta martesore, janë kryesisht të natyrës urdhëruese mirëpo ka edhe marrëdhënie martesore të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv. Martesa si institucion juridik dhe shoqëror krijon të drejta dhe detyrime reciproke në mes të bashkëshortëve të cilat ndahen në dy grupe: të drejtat dhe detyrat personale të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje dhe ato të cilat nuk mund të bëjnë. Këto të drejta dhe detyrime janë të rregulluara me nenin 42 të Ligjit për Familjen. Zgjidhja e martesës rregullohet me ligj, ndërsa mënyrat e shuarjes së martesës parashihen në nenin 60 të LFK-së të cilat janë me vdekjen e bashkëshortit, shpalljen e bashkëshortit të zhdukur të vdekur, anulimit dhe shkurorëzimit. Martesa zgjidhet vetëm pas parashtrimit të padisë dhe me vendim të gjykatës përmes anulimit (martesës së pavlefshme) ose zgjidhjes (shkurorëzimit).

Me lidhjen e martesës krijohen edhe të drejta dhe detyrime në mes të bashkëshortëve, ndërsa me zgjidhjen e saj krijohen pasoja juridike të natyrës personale juridike dhe të natyrës pasurore. Këto pasoja ndahen në dy grupe, pasojat juridike personale për bashkëshortët dhe pasojat juridike personale për fëmijët e përbashkët. Pasojat juridike për zgjidhjen e martesës në mes të bashkëshortëve janë: mbiemri, ndarja e pronës së përbashkët, kthimi i dhuratave, detyrimi i ushqimit, e drejta e banesës, trashëgimia ligjore dhe testamentare. Ndërsa pasojat juridike personale për fëmijët janë lidhur më besimin, ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijës, kujdesi ndaj tij. Përmes lidhjes së martesës, bashkëshortët hyjnë në raportet personale dhe pasurore ku Ligji i Kosovës për Familjen, parasheh se në këto raporte, bashkëshortë janë të barabartë. Në

raportet pasurore, sipas nenit 45 të LFK-së; pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë dhe e përbashkët. Pas shkëmbimit të martesës, pasuria e përbashkët mund të ndahet me marrëveshjen e bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët nuk pajtohen, ndarja e pasurisë së përbashkët bëhet në procedurë kontestimore pranë gjykatës kompetente. Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjim pasuror martesor. Në LFK, marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve rregullohen me nenet 45-57. E drejta në Kosovë njih regjimin e veçantë të pasurisë bashkëshortore dhe regjimin e përbashkët. Si pasuria e veçantë konsiderohet pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë ose përmes prodhimit të artit, punës apo pronës intelektuale. Karakteristikat e pasurisë së veçantë është se secili bashkëshort e administron dhe e posedon pronësinë e tij në mënyrë të pavarur gjatë gjithë kohës së martesës. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve rregullohet me dispozitat e LFK-së dhe më dispozitat e Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera të Kosovës. Sipas LPTDS-së Kosovës, pronësia e përbashkët mund të krijohet sipas ligjit ose përmes kontratës, pasuria e përbashkët bashkëshortore është pasuri e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Nga kjo kuptojmë që të ekzistojë kjo marrëdhënie pasurore e përbashkët martesore duhet të plotësohen dy kushte: ekzistenca së martesës dhe puna e bashkëshortëve gjatë ekzistencës së bashkësisë martesore. Karakteristikë e pasurisë së përbashkët është që bashkëshortët nuk mundën ta disponojnë pasurinë në mënyrë individuale, ata janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët vetëm nëse nuk janë marrë vesh ndryshe. Pra këtu qëndron fakti se të dy bashkëshortët janë titullarë të gjithë pasurisë në pjesët të papjesëtuara të sendeve dhe të drejtave e detyrimeve. Sipas nenit 49 të LFK-së, bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht pronësinë dhe me marrëveshje. Sipas Ligjit mbi Barazinë Gjinore të Kosovës pasuri e përbashkët nënkupton pasurinë e krijuar gjatë martesës e regjistruar në regjistrat publikë si pronë e përbashkët, në emër të dy partnerëve dhe se puna e të dy partnerëve përmes së cilës është krijuar pasuria e përbashkët, konsiderohet si kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët (Ligji Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore e Kosovës, neni 7). Neni 52 i Ligjit për Familjen sjellë parimin e njohur dhe të garantuar me Kushtetutë dhe

Konventa Ndërkombëtare sipas së cilës asnjëri nga bashkëshortët nuk mund në mënyrë arbitrare të privohen nga pasuria e tyre. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve garantohet edhe në rastet e zgjidhjes së martesës, në rastet kur pasuria e përbashkët është krijuar në bashkësi jashtëmartesore, sepse pronësia nuk mund t'i mohohet askujt, dhe as nuk mund të zhvishet nga pronësia përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Sipas nenit 56, paragrafi 2 të LFK-së, të drejtën që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët janë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet me marrëveshjen e palëve, por edhe me vendim të gjykatës. Gjatë pjesëtimit të pasurisë bazuar në nenin 54 të LFK, gjykata do të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, ndihmën e ofruar njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Ndarja e pasurisë së përbashkët bashkëshortore me marrëveshje është forma më e mirë e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Me rastin e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve njëkohësisht vjen edhe deri tek shuaja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe lindë pronësia e veçantë nëse ata janë ende në martesë për pjesën e pjesëtuar. Sipas nenit 47 par.4 të Ligjit për Familjen të Kosovës pjesët e bashkëshortëve në pronësinë e përbashkët konsiderohen si të barabarta nëse ndryshe nuk janë marrë vesh. Në rast të mosrespektimit të këtij neni nga ana e bashkëshortëve, atëherë pjesëtimi i pasurisë së përbashkët bashkëshortore do të realizohet në rrugë gjyqësore, ku secili nga bashkëshortët ka të drejtë të vërtetojë pjesët e tij në bazë të kontributit që ka dhënë për fitimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve.

E drejta prindërore si e drejtë subjektive e prindërve, është tërësi e të drejtave dhe detyrave që i ushtrojnë ata ndaj fëmijëve. E drejta prindërore është e rregulluar me nenin 128 të LMK. Një nga detyrat dhe përgjegjësitë është edhe detyrimi për ushqim. Përmbushja e këtij detyrimi nënkupton përmbushjen në mënyrë të rregullt të nevojave për ushqim, banim, përmbushjen në mënyrë të rregullt të nevojave për fëmijët e mitur dhe të nevojave për arsim, edukim dhe

nevojave kulturore. Në nenin 330 është paraparë parimi për përcaktimin e mbajtjes dhe alimentacionit. Kujdestaria e fëmijëve me rastin e shkurorëzimit është detyrë dhe e drejtë e prindërve që të kujdesen ndaj fëmijëve. Gjykata këtë veprim e ndërmerr në bashkëpunim lidhur me mendimin dhe propozimin e dhënë nga Organi i Kujdestarisë. Gjykata nuk e përjashton mundësinë që kujdestaria e fëmijëve t'i jepet edhe personave të tretë. Shumë shtetet evropiane për përgjegjësi prindërore pas shkurorëzimit bazohen në Konceptin Joint Custody apo Kujdestaria e përbashkët ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit. Kujdestaria e përbashkët nënkupton kur të dy prindërit pas ndarjes bashkëshortore marrin përgjegjësi të barabartë ndaj fëmijëve. Prindërit me kujdestari të përbashkët ndajnë përgjegjësinë dhe autoritetin ligjor për të marrë vendime të rëndësishme që ndikojnë tek ata fëmijët për çështje të tilla si edukimi, kujdesi mjekësor, praktika fetare dhe vendime të tjera thelbësore prindërore.

REKOMANDIME

Nga ky punim dalin shumë rekomandime në pjesën e terminologjisë ligjore por edhe të zgjidhjes së problemeve si: të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve, martesë, kujdesi prindëror, pasuria e përbashkët, kontributi martesor etj.

- Rekomandohet që Ligji për familjen e Kosovës nr. 2004/32 (Kodi civil i Republikës së Kosovës) të plotësohet me dispozita ligjore të cilat në mënyrë të detajuar do të rregullonin çështjet lidhur me martesën, kujdesin prindëror, pasurinë e përbashkët martesore.
- Rekomandohet që të ndryshohet Ligji për Familjen dhe Ligji për Gjykatat, sipas së cilës në kuadër të Gjykatës Themelore do të formohet departamenti familjar, i cili do të merrej me konteste martesore, të kujdestarisë së fëmijëve, alimentacionit, vërtetim të atësisë dhe amësisë, si dhe kontestet pronësore martesore.
- Rekomandohet që neni 70 I LMF të rishikohet dhe të riformulohet ashtu që afati për ushtrimin e padisë për shkurorëzim për bashkëshortët që kanë fëmijë të vegjël deri një vjet nuk mund të bëhet, të riformulohet ashtu që ky afat të shtyhet në dy vjet. Ky afat do të jetë i detyrueshëm për zgjidhjen e martesës me padi dhe me marrëveshje të përbashkët të bashkëshortëve.
- Rekomandohet që të ndryshohet neni 83 i LFK ashtu afati prej tre muaj i paraparë për pajtim të bashkëshortëve të ndryshohet në 45 ditë, ku gjykata do të merrte rolin aktiv lidhur me pajtimin e bashkëshortëve, duke caktuar tri seanca pajtimi brenda kësaj periudhe. Gjatë kësaj periudhe Gjykata do të njoftonte dhe obligonte Organin e Kujdestarisë që të ndërmerre të gjitha masat lidhur me mirëqenien e fëmijëve.
- Rekomandohet që në Kodin Civil të Republikës së Kosovës, në Librin mbi Familjen të vendoset Instituti mbi Kujdestarin e Përbashkët të Fëmijëve pas shkurorëzimit. Prindërit me kujdestari të përbashkët ndajnë përgjegjësinë dhe detyrim ligjor për të marrë vendime të rëndësishme për fëmijët e tyre lidhur me rritjen, edukimi, kujdesi mjekësor dhe vendime të tjera prindërore.

- Lidhur me të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, sipas ligjit ekzistues dy bashkëshortët kontribuojnë në familje në proporcion me aftësitë e tyre individuale, me supozim që të dy kontribuojnë barabartë në shpenzime martesore (neni 54). Çështje e diskutueshme në praktikën gjyqësore është pikërisht vlerësimi i kontributit në mes të bashkëshortëve ku njëri është në marrëdhënie pune e tjetri merret me mirëmbajtjen e punëve të shtëpisë, rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Në mënyrë të shmangies së diskriminimit, rekomandohet plotësimi i dispozitës ligjore 54 të LFK duke bërë specifikim më të mirë të kësaj norme, duhet të plotësohet-ndryshohet ashtu që të bëhet listimi i rasteve se kur nuk do të ketë ndarje të barabartë të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve si p.sh.: dispozita për përjashtimin e dukshëm të bashkëshortit plangëprishës dhe nëse bashkëshortët kanë lidhur kontratë martesore paraprakisht në formë tv aktit noterial. Pra pasuria ndahet në mënyrë të barabartë duke pasqyruar solidaritetin e martesës. Në raste të caktuara gjykata vendosë ndryshe.
- Rekomandohet që neni 54 i Ligjit për Familjen duhet të plotësohet ashtu që të definohet se kur do të përdoret ky nen, pasi që neni 47 rregullon ndarjen e barabartë të pronës së përbashkët të bashkëshortëve. Neni 54 i LFK-ës duhet të zbatohet në rast se njëri nga bashkëshortët paraqet të drejtën që i takon më tepër pasuri se $\frac{1}{2}$ ashtu siç është e rregulluar me nenin 47, *barra e provës para gjykatës do t'i mbetet bashkëshortit i cili ka një pretendim - kërkesë të tillë.*
- Rekomandohet që me Kodin Civil të Republikës së Kosovës të rregullohet kontrata martesore si institut i veçantë i rregullimit të raporteve pasurore-martesore. Gjatë rregullimit të këtij instituti ligjvënësi duhet të ketë parasysh parimin nga Neni 52 i LFK-së që asnjëri nga bashkëshortët nuk mund në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij.
- Rekomandohet që Qendrat për Punë Sociale, si organe të rëndësishme gjatë procesit të shkurorëzimit, gjatë hartimit të raporteve lidhur me kujdestarin e fëmijës, të hulumtojnë rastin, të vlerësojnë të gjitha rrethanat ku si rezultat do të reflektojë një konstatim i drejtë dhe real lidhur me kujdestarinë e fëmijës.

BIBLIOGRAFIA

- Aliu, A. (2014). *E drejta Sendore*. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Aliu, A., & Gashi, H. (2007). *E drejta Familjare*.
- Beqja, H., & Sokoli, L. (2000). *Divorci*. "Dudaj" & "Rinia 2000".
- Bicoku, N. (2011). *E drejta e trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë*. albPAPER.
- Bilalli, A., & Bahtiri, B. (2015). *E drejta Romake*. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
- FJALË Fjalor Shqip. (n.d.). Monogamia. <https://fjale.al/monogami>
- Gjata, R. (2010). *E drejta civile (Pjesa e përgjithshme)*. albPAPER.
- Ismaili, H., & Sejdiu, F. (2009). Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2006, 09 01). *Ligji për familjen*. LIGJI NR. 2004/32 LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2019, 01 14). *KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS*. KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>
- Mandro, A. (2004). *E drejta Romake*. Tiranë.
- Mandro, A. (2006). *E drejta Romake*. Tiranë.
- Mandro, A. (2009). *E drejta familjare*. Tiranë.
- Mulaj, V. (2011). *Zgjidhja e martesës në bazë të ligjit për Familjen të Kosovës*. Qendra Juridike e Kosovës.

Murru, S. (2021). Italian Legal Frame for Seperation, Divorce, and Child Custody (No. UCL - Universite Catholique de Louvain).

Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (1989, November 20). *Konventa Mbi të drejtat e fëmijës Miratuar Nga ...* - UNICEF. KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS. Retrieved April 2, 2022, from <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

Olldashi, E. (2011). *E drejta Romake*. MediaPrint.

Oruci, G. (1994). *E drejta Familjare (Ligjërata të autorizuar)*. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.

Oruci, G. (1994). *Pozita e gruas në familje dhe martesë, të drejtat dhe liritë e saj si dhe mbrojtja nga dhuna*. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.

Oruci, G. (2011). *Doracak për të drejtën familjare dhe trashëgimore*. Qendra Juridike e Kosovës.

Podvorica, H. (2005). *E drejta Familjare*. Rominor.

Podvorica, H. (2006). *E drejta Familjare* (Ribotimi i trete ed.). Universiteti AAB.

Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim". (2020, 10 15). Statusi i punësimit të rajoneve të vajzave e grave në Shqipëri e Kosovë në histori suksesi nga rajoni". *Statusi i punësimit të rajoneve të vajzave e grave në Shqipëri e Kosovë -në histori suksesi nga rajoni"*., 53.

https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Raport%20Final%20Shqip_Forum%20NORAD.pdf

Selmani, B., & Rexhepi, B. (2014). *E drejta Familjare dhe Trashëgimore*. Dinograf - Ferizaj.

Scott, E., & Derdeyn, A. (1984). Rethinking joint custody. Ohio St.Ll, 45, 455.

Zace, S. (2016). *E drejta familjare (Shënime të përmbledhura nga Vehap Hashani)*.

slideshare.com.

Zendeli, E., Selmani-Bakui, A., Mickoviq, D., & Ristov, A. (2020). *E drejta Familjare*.

Arberia Design.

LIGJET

Ligji mbi Procedurën Kontestimore i Kosovës, 2008,

Ligji nr. 03/L-006 11. Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës,

Ligji. Nr. 2/2004 12. Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji nr. 2004/32 13,

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje i Kosovës, Ligji nr. 03/L-182 14,

Ligji për Procedurën Jokontestimore i Kosovës, 2008,

Ligji Themelor për Martesën i ish RSFJ, 1946,

Ligji nr. 03/L-110 15. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Kosovës,

Ligji nr. 03/L-154 16. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare i Kosovës,

Ligji nr. 02/L-17 17. Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, Ligji nr. 2004/2.